



الملك لله



Sprova e Pasurisë



OSMAN NURI TOPBASH





Shkodër / 2020

© Progresi Botime - Shkodër: 1441 H / 2020

Sprova e pasurisë

Osman Nuri TOPBASH

Titulli original: Müslümanın para ile imtihanı

Autor: Osman Nûri Topbash

Përkthyes: Albert Halili

Redaktor: Ilir Hoxha

Dizajni: Bledar Xama

ISBN: 978-992-820-73-88

Adresa: Sheshi “2 Prilli” / Rr: Studenti /
Shkodër / Shqipëri

Tel: +355 67 340 6182

E-mail: rev.etika@gmail.com

Website: www.progresibotime.com

Sprova e pasurisë

Osman Nuri TOPBASH

PARATHËNIA

Falënderime pafund i takojnë Allahut i cili na krijoi nga asgjëja, na begatoi me të mira pafund dhe na vendosi në tokë, në arenën e sprovave për të provuar cili nga ne është më i mirë.

Përsëritet dhe bekime pa fund për Pejgamberin ﷺ prijësin, udhërrëfyesin dhe shembullin tonë të përsosur në këtë vend sprovash, po ashtu përsëritet dhe bekime për familjen dhe shokët e Tij të dashur...

Besimtarët nuk duhet të harrojnë faktin që Islami përveç të qenurit një sistem fetar është edhe stil jetese. Islami, në sistemin e vet përfshin të gjitha rregullat praktike ideale për ne sepse Ai zotëron një sistem juridik i cili trajton të gjitha çështjet e jetës në mënyrë të detajuar, zotëron një tërësi kriteresh tej mase të qarta dhe zotëron një botëkuptim të përkryer.

Islami nuk rregullon vetëm jetën fetare dhe rituale të muslimanit por ai rregullon sipas kriterëve hyjnore moralin, sjelljet, detyrimet dhe të drejtat e tij në rrafshin shoqërorë, pra në të njëjtën kohë merr përsipër rregullimin marrëdhënies shoqërore.



Prandaj një besimtar i cili i ka përvetësuar me gjithë qenien e tij shpirtin dhe formën e Islamit në radhë të parë është një njeri i matur, i sjellshëm i cili punon dhe përpiket për të fituar dashurinë hyjnore. Ai është parimor, i matur udhërrëfyes. Nuk mund të imagjinohet që një besimtarë të shfaqë veprime të nxituara, egoiste dhe të pa matura. Sidomos në marrëdhëniet tregtare dhe ekonomike, besimtari nuk mund të bëhet pjesë e mentalitetit zemërngushtë kapitalist i cili nuk njeh kriter tjetër përveç përftimit dhe interesit të vet material, sepse mëshira, drejtësia, përgjegjësia, besnikëria dhe kufijtë hallall-haram janë cilësi të qenësishme të karakterit të muslimanit. Por këto cilësi herë pas herë mund të mbulohen nga tisi i përfitimit material, gjë e cila ndodh kur dhënia mbas pasurisë së kësaj bote e shtyp ndjeshmërinë për botën tjetër. Kjo sjellë kalimin në plan të dytë të prioriteteve shpirtërore. Njeriu që nuk e jeton atë që beson, beson atë që jeton. Pikërisht këtu fillon rreziku i madh.

Ndërsa kryerja e një veprimi të ndaluar duke qenë i vetëdijshëm për dispozitën ligjore të ndaluar të tij konsiderohet mëkat, kryerja e një veprimi të ndaluar duke e legjitimuar atë sjellë daljen nga rrethi i besimit. Sigurisht që kjo është një fatkeqësi e madhe e cila sjell humbjen e botës së amshuar.

Rrënimin e madh që ka sjellë mentaliteti kapitalist dhe kolonizimi kulturor global mbi vlerat shpirtërore është krejtësisht i qartë dhe i dukshëm nga të gjithë.

Interneti dhe televizioni e ka shndërruar brezin e ri në një robot të cilin e komandon si të dojë.

Me bindje të plotë mund të themi se rolin e armëve për pushtimin e një vendi e ka marrë media përmes secilës realizohet pushtimi kulturor.

Ky ekspansion kulturor global po i imponohet në mënyrë tinëzare bashkësisë islame. Ky ekspansion po helmon vlerat shpirtërore, po zbraz botën e brendshme dhe po e shndërron shoqërinë tonë në një shoqëri egoiste dhe pragmatiste.

Imani ndodhet nën sulmin e vazhdueshëm të frymës materialiste dhe hedoniste, vlerat morale dhe virtytet çdo ditë e më tepër po zhvlerësohen, njeriu po zhvishet nga mëshira dhe dhembshuria duke krijuar një tip njeriu të pandjeshëm si një makinë robotike. Shkurtimisht rrugët e qetësisë dhe lumturisë shpirtërore të shoqërisë po mbushen me gjemba, xhama dhe pengesa të tjera të cilat e bëjnë të pamundur kalimin nëpër të.

Allahu na informon në Kuran se shejtani do të jetë shumë aktiv në pasurinë dhe fëmijët tanë. Detyra e shejtanit është shthurja dhe lajthitja e njeriut. Për sa i përket fëmijëve ai përpiket t'i devijojë dhe t'i çojë drejt shthurjes përmes epshit, pasionit dhe egos, kurse për sa i përket pasurisë e nxit njeriun ta fitojë atë në rrugë haram duke e zhytur në këtë mënyrë njeriun në batakun e shthurjes dhe devijimit.

Për të përballuar, mënjanuar dhe mbajtur një qëndrim duke ruajtur personalitetin dhe ndjeshmë-

rinë islame duhet të kapemi më fort se kurrë mbas vlerave shpirtërore.

Në lidhje me temën në fjalë janë botuar në revistën “Etika” dy intervista tona. Më vonë menduam ta botojmë më të zgjeruar në një libërth me shpresën për të qenë sa më i dobishëm për lexuesin.

Lusim Allahun t’i përjetësoi përfitimet të cilat shpresojmë të vijnë prej këtij libri. Lusim Allahun të na nxjerrë faqebardhë dhe fitimtarë përballë sprovës së pasurisë dhe të na japë një zgjuarsi dhe intuitë që mirësitë e kësaj botë t’i shndërrojmë kapital për botën tjetër.

Amin...

**Osman Nuri Topbash
Tetor 2012
Yskydar**

Me Hoxhën Osman Nuri Topbash

Rreth sprovimit të myslimanit me pasuri

Pyetje: *Kohët e fundit po flitet dhe shkruhet shumë në lidhje me marrëdhënien e besimtarit me pasurinë dhe paranë. Pasuria e fituar përmes lidhjes me politikën, dhënia pas luksit, shpenzimi pa kriter, përdorimi i kredive, kryerja e veprimeve me kamatë etj...*

Në lidhje me këtë gjendje po vijnë kritika të ndryshme nga brenda dhe jashtë.

Ju duke parë gjendjen aktuale dhe duke qenë një person që interesoheni për problemet e njerëzve sidomos të muslimanëve, çfarë problemi do të theksonit në marrëdhënien e muslimanëve me pasurinë?

Hoxha Osman Nuri Topbash:

Faktorët që ndikojnë më tepër në karakterin e njeriut janë dy: i pari është mjedisi shoqëror dhe i dyti fitimi i pasurisë.

Prandaj duhet të tregojmë shumë kujdes se me



cilin shoqërohem sepse njeriu shpesh ndikohet nga shoqëria për kryerjen e një veprimi të mirë apo të keq.

E dyta duhet të tregojmë kujdes dhe ndjeshmëri maksimale në mënyrën e fitimit të pasurisë. Në asnjë mënyrë nuk duhet ta ndotim pasurinë me haram.

Bota shpirtërore e njeriut formësohet sipas gjendjes së këtyre dy faktorëve, për pasojë veprat dhe sjelljet e njeriut do të realizohen dhe marrin formë sipas formës shpirtërore.

Pasuria si të fitohet shpenzohet, nëse është fituar në mënyrë legjitime shpenzohet për mirë dhe nëse është fituar në rrugë haram shpenzohet dhe akumulohet si kapital për të keqen.

Pasuria është faktor përcaktues në rrjedhën e kaderit të njeriut. Të gjithë mendojnë se mund ta zotërojnë dhe përdorin si të duan parane, mirë po pasuria

shpenzohet siç fitohet dhe në të shumtën e rasteve është ajo që e tërheq njeriun sipas drejtimit të vet. Pra në pjesën më të madhe sundimi është i pasurisë dhe jo i zotëruesit të saj.

Pasuria është si gjarpri i cili del nga vrima që ka hyrë. Vepra e atij që fiton pasuri haram zhvlerësohet

Në një hadith Profeti ﷺ thotë:

“Bota është e ëmbël dhe pamja e saj është e hijshme. Padyshim që Allahu do t’u japë drejtimin e botës dhe do të shikojë se si do të silleni, çfarë punësh do të bëni. Prandaj kini kujdes nga bota.”

(Muslim, Dhikër, 99)

dhe singeriteti në vepra i zhduket.

Prandaj është shumë e rëndësishme mënyrë e fitimit të pasurisë. Për të siguruar mirëqenie materiale dhe qetësi shpirtërore duhet të tregojmë shumë kujdes në mënyrën e fitimit të pasurisë.

Në lidhje me këtë çështje ngjarja e Behlul Danës është shumë mbresëlënëse:

Behlul Dana kërkon një punë nga Harun Rashidi, kalifi i shtetit islam. Harun Rashidi i jep detyrën e inspektorit të tregut.

Behluli menjëherë fillon punën. Fillimisht shkon tek një furrë buke ku peshon disa bukë për të kontrolluar peshën e bukës. Të gjitha bukët e peshuara dalin nën peshë. Behluli e pyet:

“ - A je i kënaqur me mënyrën e jetesës, a e siguron jetesën me punën që bën? A keni harmoni dhe lumturi në familje?

Furrtari i jep të gjitha pyetjeve përgjigje negative. Behluli largohet prej aty, pa thënë asgjë, për të shkuar në një furrë tjetër. Edhe aty peshon disa bukë, të gjitha bukët e peshuara dalin disa gramë mbi peshën standarde. Të njëjtat pyetje i bën edhe furrtarit të dytë dhe për të gjitha pyetjet merr përgjigje pozitive. Furrtari ishte mjaft i lumtur dhe i kamur.

Pas kësaj menjëherë shkon tek Harun Rashidi dhe i kërkon një punë tjetër. Harun Rashidi:

“ - Sa shpejt u mërzite nga puna që sapo fillove?

“- Zotëri, - i thotë Behluli- tregu e kishte kontrollorin e vet. Ai kishte peshuar bukët dhe ndërgegjen e njerëzve para meje. Dhe sipas gjendjes, çdo njëri paguante detyrimin. Aty nuk kishte nevojë për mua...”

Mjerë për ata që hanë në peshë (dhe matje), që, kur masin për veten, e marrin masën të plotë, ndërsa, kur u masin të tjerëve me litër ose me kandar, ua pakësojnë. A nuk mendojnë ata se do të ringjallen në një Ditë të madhe, Ditën, kur të gjithë njerëzit do të dalin para Zotit të botëve?!

(Mutaffifin, 1-6)

Pra, mënyra e fitimit të pasurisë është kushti i parë i qetësisë materiale dhe shpirtërore, sepse çdo qindarkë e fituar hallall i jep njeriut gjallëri shpirtërore. Kurse çdo qindarkë haram e zhyt njeriun në moçalin e harresës dhe neglizhencës së parimeve fetare. Në këtë mënyrë zemra e tij mbulohet nga tisi i neglizhencës dhe indiferencës.

Ali Ramiteni lexoi hadithin; *“Ibadetet janë dhjetë kategori; nëntë janë të kërkosh hallallin, ndërsa e dhjeta përfshin të gjitha ibadetet.”* - dhe tha:

“Kush nuk ushqehet me hallall, nuk mund të gjejë fuqi për t’iu bindur Allahut, sepse ai vazhdimisht është i prirur pas dëshirave epshore dhe egoiste. Kurse ai që ushqehet me hallall, nuk e kundërshton Allahun...”

Pra, fitimi hallall është ndër faktorët kryesorë të devotshmërisë.

Kur e pyetën Sufjan Theurin për rëndësinë dhe vlerën e faljes në rresht të parë, ai, duke tërhequr vëmendjen drejt fitimit hallall tha:

“Ju shikoni mënyrën e fitimit të pasurisë; nëse fitimi është hallall falu në cilin rresht të duash.”

Kurse në një rast tjetër tha:

“Devotshmëria e njeriut është në raport të drejtë me mënyrën e fitimit të pasurisë.”

Fatkeqësisht, mentaliteti kapitalist i ka dëmtuar aq shumë vlerat shpirtërore, saqë edhe besimtarët nuk po e respektojnë më moralin Islam në marrëdhëniet e tyre tregtare. Shumë besimtarë, të cilët falin namaz dhe shkojnë në haxh, i dëgjon duke thënë se, “për të bërë bamirësi duhet të fitojmë më shumë”. Mirëpo, në fakt ata janë duke bërë gabime të papranueshme për moralin Islam, sepse tek ata thjesht mbizotëron mendimi për të fituar pa treguar kujdes në mënyrën e fitimit.

Akoma më keq është legjitimimi i haramit. Kjo është më e rëndë dhe më e rrezikshme se sa vetë veprimi, sepse një person që mendon kështu, është i rrezikuar të dalë nga rrethi i Islamit. Rreziku në legjitimimin e një veprimi haram, krahasuar thjesht me kryerjen e veprimit haram, qëndron tek dëmtimi që i jep besimit.

Një pjesë e atyre që në marrëdhëniet e biznesit dhe tregtisë nuk respektojnë moralin Islam, ngushëllohen me faktin se janë të detyruar t'i përshtaten rregullave të sistemit kapitalist. Por njeriu nuk është



i detyruar të zgjedhë tregtinë për të siguruar jetesën. Ai nuk është i detyruar të orientohej drejt zgjidhjeve jo Islame. Për më tepër, ai nuk është aspak i detyruar të legjitimojë haramin.

Një dollar hallall, është më i vlefshëm se njëqind dollar të fituar në rrugë të dyshimta apo haram. Fiti mi haram ndot botën shpirtërore dhe prish qetësinë e zemrës. Kurse fitimi hallall dhe i pastër, i siguron njeriut qetësi dhe begati.

Si gjithmonë, pjesa më e madhe e njerëzve, kur nuk jetojnë sipas besimit, fillojnë të besojnë sipas mënyrës që jetojnë. Në fillim, kryejnë disa veprime jo legjitime në marrëdhëniet tregtare. Me kalimin e kohës, arrihet deri në legjitimimin e tyre përfundimtar.

Prandaj, ata që janë të angazhuar me tregti, duhet të tregojnë jashtëzakonisht kujdes që në fillim për t'u mbrojtur nga harami, pa arritur gjendja deri aty sa tu dëmtojë besimin.



MENTALITETI “KËSHTU FUNKSIONON SOT”

Reklamat jo të nderhme dhe marrja në punë e sekretareve të bukura për të tërhequr klientë, janë disa nga gabimet që bien më shumë në sy në marrëdhëniet e biznesit dhe tregtisë. Ngaqë pasioni për përfitim material ka kaluar mbi dashurinë për botën tjetër, egoja e ngushëllon njeriun me justifikime të kota si: “Kështu funksionojnë punët në këtë kohë!”

Asnjë gabim dhe veprim i gabuar nuk mund të ketë justifikim dhe qëllim të drejtë. Shkelja e kriteve në emër të bamirësisë, është një kurth shumë dinak dhe i rrezikshëm.

Mentaliteti kapitalist i cili beson se shoqëritë dhe sistemet përcaktohen nga kapitali, jo vetëm që është krejtësisht i zbrazët nga ana shpirtërore, por ai e dëmton rëndë dhe rrënon botën shpirtërore të njeriut, sepse ky sistem nuk frymëzon mëshirë dhe përgjegjësi morale, përkundrazi, ai sjell harrimin e tyre. Në emër të fitimit, sistemi kapitalist e konsideron çdo gjë të lejuar. Sistemi kapitalist nuk intereso-



het aspak për gjendjen shpirtërore të shoqërisë.

Në emër të fitimit dhe rritjes së kapitalit, mentaliteti kapitalist bën reklamën dhe propagandën e kulturës së shpenzimit përmes modës dhe promociioneve marramendëse. Kjo, sepse kapitalizmi e merr energjinë prej shpenzimit të tepruar.

Prandaj, ne duhet ta mbrojmë veten nga orientimi drejt ekonomisë dhe kulturës së shpenzimit, sepse shpenzimi i tepërt e shkatërron shoqërinë.

Mos ia merrni pasurinë njëri-tjetrit padrejtësisht! Dhe mos u bëni mitëdhënës te gjykatësit për t'ua përvetësuar në mënyrë të paligjshme dhe me vetëdije njerëzve një pjesë të mallit.

(Bekare, 188)

Edhe kartat e kredit janë kurthe ekonomike për të rritur shpenzimet e njerëzve. Në asnjë mënyrë shpenzimet nuk mund të shërbejnë si justifikim për këtë.

Ky është një kurth që tërheq të varfrit në mënyrë të pamëshirshme, me qëllim që të fitohet në kurriz të tyre. Një gjë e tillë nuk është rrezik vetëm për besimin, por është shkak për shembjen dhe rrënimin moral të shoqërisë.

Përgjegjësit kryesor të kësaj, janë të pasurit oportunistë dhe neglizhentë, të cilët në vend që të bëjnë një jetë të thjeshtë dhe modeste, jetojnë në një luks marramendës duke vështirësuar në këtë mënyrë jetën e njerëzve të varfër.

Kur humbet modestia, që është një nga urdhëresat kryesore të fesë, dhe dobësohet institucioni i zekatis, lëmoshës dhe dhurimit, të cilët synojnë

mbylljen e hendekut që ekziston midis të varfërve dhe të pasurve, shoqëria e humbet harmoninë dhe, një pjesë e mirë njerëzve bëhen kurban i këtij sistemi. Për rrjedhojë, shumë njerëz janë bërë kurban i këtij sistemi nën ndikimin e reklamave jo të ndershme.

Nëse një vajzë e varfër bombardohet nga reklammat e modës duke e orientuar atë drejt rrymës, bota e saj përmbysset... Përballë kësaj gjendjeje, ajo përfshihet nga ambicia dhe lakmia për të bërë një jetë, e cila në të vërtetë nuk ekziston, dhe që për më tepër, kushtet ekonomike të saj nuk ia lejojnë. Por, për të arritur qëllimin, ajo ndjek rrugën më të keqe, duke u shndërruar më në fund në mbeturinë të shoqërisë.

Që shpirti jonë të gjejë qetësi, zemra jonë duhet të zbukurohet me trëndafilat e modestisë dhe thjeshtësisë.



RRËNOJA NJERËZORE

Ekspansioni kulturor global dhe ndikimi negativ i medias e internetit po helmojnë botën shpirtërore, duke shkaktuar verbërimin e saj. Sistemi kapitalist çon ujë në mullirin e shpërdorimit dhe shpenzimit pa kriter.

Pasoja e kapitalizmit të egër, është rrënoja njerëzore, sepse ai shkul nga zemrat mëshirën dhe dhembshurinë. Sistemi kapitalist verbon ndjenjat e mëshirës dhe dhembshurisë. Ai mbyll të gjitha portat e shërimit të shpirtit.

Në sistemin kapitalist, socialist dhe komunist nuk ka vend për virtytet dhe çështjet shpirtërore. Sipas njërit sistem, kapitali i përket shoqërisë, kurse sipas tjetrit, individit. Këto sisteme kanë divergjenca në lidhje me përkatësinë e pasurisë, por në të dy sistemet sundon mentaliteti oportunist dhe kolonist. Individi është vetëm një ingranazh në tërë mekanizmin.

Kurse në Islam, si çdo gjë tjetër, edhe pasuria i përket Allahut. Pra, zotëruesi absolut i pasurisë është



Allahu. Ndërsa njeriut thjesht i është dhënë e drejta për ta përdorur për një afat të caktuar.

Duke qenë se në qendër të botëkuptimi Islam është Allahu, shkelja e ligjeve hyjnore, cenimi i të drejtave të tjetrit dhe shfrytëzimi i njeriut është jo-legjitim. Shkalla e parë e ekonomisë Islame është zgjidhja e problemit të njerëzve. Në Islam, ndihma ekonomike dhe ndarja e pasurisë me nevojtarët është obligim fetar. Allahu në Kuran urdhëron:

“Në pasuritë e tyre ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtarët.” (Dharijat, 19)

Kjo normë është metodë mësimi për përdorimin e parasë, dhe në të njëjtën kohë, është mjet për të bashkuar dhe solidarizuar zemrat e njerëzve.

Si në çdo fushë të jetës, Islami ka vendosur një sistem edhe në fushën ekonomike. Ai ka vendosur kufijtë hallall-haram në të gjitha fushat e jetës, inkurajon mëshirën dhembshurinë dhe drejtësinë. Edhe fitimin e pasurisë e kërkon prej rrugëve të lejuara.

Sistemi kapitalist mendon vetëm përfitimin material. Sipas sistemit kapitalist, njeriu është thjesht një ingranazh që vë në lëvizje sistemin ekonomik. Prandaj ky sistem e përdor njeriun në mënyrë çnjerëzore dhe, për të arritur qëllimin, përlij çdo lloj mjeti.

Kurse Islami, në lidhje me pasurinë bën pyetje thelbësore si: **“Ku dhe si e fitove pasurinë, për çfarë dhe si e shpenzove?”**

TRE PARIMET E ISLAMIT

Përdorimi i pasurisë siç duhet është art në vete. Në lidhje me pasurinë duhen respektuar medoemos tre parime:

- 1) Fitimi i pasurisë në rrugë hallall.
- 2) Shmangia e shpërdorimit dhe shpenzimi pa kriter.
- 3) Qëndrimi larg koprracisë.

Shpenzimi pa kriter duke demonstruar fuqi, në fakt është përpjekje për të mbuluar ndjenjën e inferioritetit. Ndërsa koprracia është akumulimi i pasurisë nga frika e varfërisë dhe shmangia nga bamirësia. Kjo vjen si pasojë e frikës dhe mungesës së besimit të plotë tek Allahu. Dorështrenguarit, pasurinë e konsiderojnë si të vetmin mjet mbështetje dhe shpëtimi. Si shpenzimi pa kriter, ashtu dhe koprracia, janë shprehje e kundërshtimit ndaj zotëruesit të vërtetë të pasurisë, Allahut të Madhëruar.

Në ndryshim me shpërdoruesin dhe koprracin, besimtari duhet të jetë bujar. Besimtari bujar është vazhdimisht bamirës ndaj njerëzve. Besimtari përpigjet të fitojë më shumë pasuri, për të bërë më shumë bamirësi.



Në mbi 200 ajete të Kuranit Fisnik, besimtarët nxiten për bamirësi. Kurse Hadithi Profetik;

“Dora që jep është më e mirë se dora që merr” është inkurajim për të kontribuar me pasuri në rrugë të Allahut.

Ndërgjegjja e besimtarit të devotshëm, vazhdimisht bën pyetje të tilla si: “Sa punove për vete, dhe sa për të tjerët në këtë ditë të re? Allahu ty të ka dhënë mirësi të cilat nuk i kanë të tjerëve, prandaj ti ke detyrime ndaj tyre...”

Në lidhje me këtë, Allahu urdhëron në Kuran: **“Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë ty Allahu.”** (Kasas, 77)

Prandaj, një besimtar i pjekur, është gjithmonë i gatshëm për të flijuar të mirën vetjake për të mirën e të tjerëve. Ai gjithmonë dëshiron dhe synon t'i bëjë mirë tjetrit. Të gjitha këto nuk i bën për ndonjë përfitim material, por thjesht për të fituar dashurinë e Allahut.

Rumiu e ilustron shumë bukur këtë atmosferë përgjegjësie të besimtarit ndaj shoqërisë.

“Shemseddini më mësoi një gjë: “Nëse në botë ekziston qoftë një besimtarë i vetëm që nuk ka mundësi të ngrohet, atëherë as ti nuk ke të drejtë të ngrohesh.” Unë e di që në botë ka besimtarë të cilët nuk kanë mundësi të ngrohen, prandaj unë nuk mund të ngrohem ndërkohë që vëllezërit e mi vuajnë nga i ftohti!..”

Shemseddin Tebrizi i mëson Rumiut ndjeshmë-



rinë shoqërore. Ndërkohë që ngrohja e trupit bëhet e mundur përmes rrobave dhe zjarrit, ngrohja e ndërgjegjes së njeriut bëhet e mundur përmes mëshirës. Kjo ndjeshmëri duhet të tregohet ndaj çdo krijese. Besimtari e ndjen përgjegjësinë ndaj çdo besimtari tjetër kudo që ndodhet.

Qëllimi i besimtarit duhet të jetë fitimi i dashurisë së Allahut. Mjeti i tij, është personaliteti shembullor Islam. Kurse përfundimi, një individ prej të cilit përfiton i gjithë ymeti Islam, madje gjithë krijesat.



*Dynjaja mund të shndërrohet në parajsë
përmes tre gjërave:*

- 1) Dhurimit të pasurisë,
fjalës dhe ndjenjave.*
- 2) Faljes*
- 3) Dhe këshillave për njerëzit e padrejtë.*



KRAHASIMI I ISLAMIT ME KAPITALIZMIN

Pyetje: *Në botën perëndimore feja duket krejtësisht e tërhequr nga jeta shoqërore. A po e merr kapitalizmi rolin e fesë edhe në vendet muslimane, dhe a ka mundësi që edhe Islami të përfundojë si krishterimi përballë kapitalizmit, duke u tërhequr plotësisht nga jeta shoqërore?*

Osman Nuri Topbash: Kapitalizmi lindi dhe u përhap në botën dhe shoqërinë kristiane. Në krishterim, feja është e ndarë nga politika. Shprehja, “Jepi Çezarit atë që i takon Çezarit dhe Zotit atë që i takon Zotit” konfirmon pikërisht këtë botëkuptim të krishterimit në lidhje me jetën politike. Krishterimi nuk është i interesuar për jetën shoqërore, sepse rregullimi i saj i është lënë shtetit. E vetmja gjë që predikon krishterimi, është mëshira. Por mëshira është relative; ajo ndryshon nga personi në person. Prandaj kapitalizmi është përhapur me shpejtësi në shoqëritë e krishtera, sepse në to kanë munguar vlerat shpirtërore të cilat mund t’i kundërviheshin kapitalizmit.



Kurse rasti me fenë Islame është krejt ndryshe. Botëkuptimi Islam përfshin të gjitha aspektet e jetës së njeriut. Madje, edhe jetën ekonomike. Nëse besimtarët i zbatojnë rregullat ekonomike që ka vendosur Islami, nuk ka nevojë për një sistem tjetër ekonomik në shoqërinë Islame. Por, nëse muslimanët nuk i zbatojnë rregullat shoqërore dhe ekonomike, duke krijuar në këtë mënyrë hapësira boshe, mbushja e këtyre hapësirave nga sisteme të tjera është i pashmangshëm.

Përgjegjësia kryesore në lidhje me këtë çështje i takon besimtarëve. Allahu tregon parimet e domosdoshme për një jetë të lumtur, ndërsa zbatimi i tyre është detyrë e muslimanit.

Nëse islami jetësohet në jetën shoqërore, ekspansioni i kapitalizmit në shoqërinë Islame është i pamundur. Ndikimi i kapitalizmit në shoqërinë Islame është në raport të drejtë me zbatueshmërinë e Islamit në shoqëri.



EPOKA E TULIPANËVE

Pyetje: *Po të hedhim një sy mbrapa në histori, në periudhën kur sundonte vlera dhe kultura Islame. Për shembull, në epokën e tulipanëve në shoqërinë Osmane, vejmë re se kur muslimanët kanë poseduar pasuri të madhe, kanë filluar të shkajnë nga rruga e drejtë. Kjo gjë mund të thuhet edhe për epokat më të hershme. Kurse sot, edhe pse Islami ekziston në shoqëri, ai nuk mbizotëron si sistem. Në të vërtetë, sistemi që mbizotëron sot edhe në shoqëritë myslimane, është ai global, pra sistemi kapitalist.*

Lind pyetja: Si do të rezistojmë? Ndërkohë që pasuria e tepërt ka arritur të shndërrojë shoqërinë kur kanë mbizotëruar vlerat Islame, atëherë sistemi kapitalist që sot është mbizotërues, e tjetërsion edhe më tepër shoqërinë Islame. Në këtë rast, pyetja që bëhet më shpesh është: Edhe sa do të durohet ky tjetërsim? Si mund ta mbrojë besimtari veten në shoqërinë kapitaliste? A ka ndonjë justifikim? Ndoshta prej këtu duhet ta fillojmë!..



Osman Nuri Topbash: Faktorët që i çojnë njerëzit në sjellje të gabuara, kanë ekzistuar në çdo kohë dhe çdo shoqëri. Kjo buron ngaqë jeta e njeriut është një arenë sprove. Siç thuhet në ajetin kuranor:

“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?! (Ankebut, 2.)

Nëse në këtë botë nuk do të ishin një sërë faktorësh që e nxisin njeriun në sjellje të gabuara, nuk do të kishte asnjë arsye përse duhej të shpërblehej njeriu për të vepërimet e drejta dhe të mira. Allahu ka krijuar krijesa të cilat nuk kanë asnjë pengesë në adhurimin ndaj Allahut, siç janë melekët.

Kurse njerëzit dhe xhinët, Allahu i ka krijuar të aftë të demonstrojnë vepra të mira dhe të këqija. Faktorët që e nxisin njeriun për veprime të këqija, janë të brendshëm dhe të jashtëm. Një faktor i brendshëm është egoja e tij, ndërsa faktorë të jashtëm janë kurthet joshëse të palejuara.

Vlera e çdo fitoreje është në raport të drejtë me vështirësitë që përballon për të arritur atë fitore. Madje, edhe një prind e shpërblen fëmijën e vet për një vështirësi të përballuar me sukses. Nuk ka gjë më normale se kjo. Nëse ne arrijmë të kapërcejmë pengesat e egos dhe shejtanit duke i kryer me sukses detyrat tona në këtë botë, Allahu na ka premtuar

Profeti ﷺ ka thënë:
Kënaqësitë e kësaj bote janë dhimbjet e botës tjetër. Ndërsa dhimbjet e kësaj bote janë kënaqësitë e botës tjetër.”

(Hakim, Mustedrek, IV, fq.345)

qetësi dhe lumturi në këtë botë dhe në botën tjetër. Duke qenë se natyra e kësaj bote është sprova, e keqja, herë më pak e herë më shumë, do të ekzistojë gjithmonë. Edhe periudha në të cilën jetojmë nuk bën përjashtim nga ky rregull.

Por duke qenë se vështirësitë janë më të mëdha në këtë periudhë, edhe përballimi me sukses, sjell shpërblim më të madh.

Prandaj, kushtet e vështira nuk mund të shërbejnë si justifikim për asnjë. Përkundrazi, besimtarët janë të obliguar të luftojnë për të ndryshuar kushtet dhe jo të shfaqin dobësi përballë vështirësive. Në emër të nderit që vjen nga ecja në rrugën e Allahut, besimtarët duhet të jenë gjithmonë të gatshëm për të ndryshuar realitetin, dhe jo për t'iu përshtatur atij. E gjitha kjo është e mundur vetëm përmes një jete të përkushtuar dhe të devotshme.

“Ata që duan fenë nuk dalin nga kjo botë, kurse ata që duan këtë botë dalin nga feja.”

- Aforizmë -

Devotshmëria është flakja tutje e dëshirave të egos, kultivimi i virtyeteve shpirtërore dhe ndërgjegjësimi i njeriut se ai ndodhet përherë nën vëzhgimin hyjnor. Pasurimi i zemrës me këto ndjesi, është shenja më e rëndësishme e devotshmërisë. E vetmja mënyrë për të shpëtuar nga sprovat e kësaj periudhe është strehimi në devotshmëri. Rëndësia e devotshmërisë, pikësëpari vihet re në mënyrën si fitohet dhe si shpenzohet pasuria. Sepse në marrëdhëniet tregtare të periudhës sonë mbizotëron sistemi jo Islam, gjë që e bën më të vështirë mbrojt-

tjen nga rreziqet. Për rrjedhojë, devotshmëria në një gjendje të tillë duhet të jetë shumë më e ndjeshme. Besimtari i devotshëm është i vetëdijshëm se pasuria është rrizk prej Allahut. Prandaj ai është gjithmonë i kënaqur me gjendjen e tij, gjë e cila vihet re në gjithë qenien e tij.

Në fakt, pasuria është me të vërtetë çështje caktimi. Mund të jetë një person që nuk ka asnjë përvojë në biznes, por ka një pronë e cila mund të fitojë vlerë menjëherë, e ai bëhet i pasur dhe fillon të mburret se ka fituar pasuri.

“Me të vërtetë, Zoti yt i jep me bollëk e ia kufizon (riskun) kujt të dëshirojë; Ai i di dhe i sheh mirë robërit e Vet.”

(Isra, 30)

Kurse një tjetër, i cili ka përvojë dhe është i zoti në fushën e biznesit, mund të mos ketë sukses me gjithë përpjekjet e tij. Një fjalë e urtë popullore thotë: “Ka disa njerëz që gurin e bëjnë ar, e disa të tjerë që arin e bëjnë gurë.”

Në suren Fexhr, Allahu thotë:

“Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: “Zoti im më ka nderuar.” (Fexhr, 15.) kurse në vazhdim të ajetit thuhet: **“Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: “Zoti im më ka poshtëruar”.** (Fexhr, 16.)

Pra nuk dihet çfarë mund të sjellë me vete pasuria; dobi apo dëm. Prandaj, një besimtar as nuk gëzohet shumë kur fiton dhe as nuk mërzitet shumë kur humbet. Në çdo situatë, zemrën e ka të qetë

dhe të lidhur fort pas Zotit. Sepse besimtari është i vetëdijshëm se për të fituar dashurinë e Allahut, duhet të jetë i kënaqur me caktimin e Tij. Sido që të jetë gjendja e tij ekonomike, besimtari duhet të jetë gjithmonë në gjendje falënderimi dhe dhikri. Asnjëherë nuk duhet t'i kalojë nëpër mend përse ai tjetri ka, e ai vet nuk ka. Besimtari duhet ta ruaj rrugën e drejtë përballë çdo vështirësie duke u strehuar mbas mburojës së fortë të durimit, dhe asnjë herë nuk duhet ta harrojë fjalën e Profetit ﷺ: *“Jeta e vërtetë është jeta e ahiretit.”*

Të shprehësh gëzim kur Allahu të jep pasuri dhe të shprehësh pakënaqësi kur të privon nga ajo, nuk përputhet aspak me fjalën Islam, e cila nënkupton nënshtrimin dhe dorëzimin e plotë ndaj Allahut. Por, njeriu nuk mund të shpëtojë nga kjo dobësi njerëzore pa u pjekur shpirtërisht. Vetëm ata që pastrojnë egon dhe dorëzohen plotësisht përballë caktimit hyjnor, çfarëdo qoftë ai; pozitiv apo negativ, nuk ankohen por thjesht i dorëzohen caktimit të Krijuesit të gjithësisë. Sa lajm i bukur është ajeti kuranor për besimtarë të tillë:

“O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty. Bashkohu me robërit e Mi, dhe hyr në Xhenetin Tim!”

(Fexhr, 27-30.)

“U shkatërroftë rob i floririt dhe i argjendit që vesh rrobën e mendjemadhësisë! Njeriu i pangopur gëzohet nëse i jepet ajo që dëshiron. Nëse nuk i jepet, nuk i pëlqen, mërztet, e ngrihet kundër caktimit hyjnor.”

(Buhari, Rikak, 10, Ibn Maxhe, Zuhd, 8)

A ËSHTË DOBËSIA JUSTIFIKIM?

Pyetje: *A është justifikim gjendja e dobët e muslimanëve? A mund të konsiderohet një justifikim gjendja e dobët e muslimanëve përballë sistemit kapitalist?*

Osman Nuri Topbash: Një gjë e tillë është e pranueshme, sepse shoqëria e Epokës së Lumturisë në fakt nuk ishte një shoqëri e pasur. Përkundrazi, shoqëritë përreth që dëshironin t'i zhduknin ata, ishin shumë më të pasur dhe më fuqishëm. Megjithatë, për t'u bërë e fortë si kundërshtarët, shoqëria muslimane nuk ndoqi metodën e tyre të bazuar në kamatë dhe fitim jo legjitim. Madje, muslimanët as nuk e shkuan në përmend një gjë të tillë. Por, të bindur se fuqia dhe forca e vërtetë vjen vetëm prej Allahut, punuan dhe u përpoqën duke u mbështetur fort tek Allahu. Çlirimet më të mëdha u bënë në kohën e sahabëve. Sepse forca shpirtërore gjithmonë ka triumfuar mbi forcën materiale.

Ajeti kuranor e shpreh shumë bukur këtë të vërtetë:



**e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe!
Allahu është me të durueshmit.”** (Bekare, 249.)

**“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje
ndihmë Kërkojmë.”** (Fatiha, 5.)

Siç mund të kuptohet lehtë edhe nga ajeti i surres Fatiha, ndihma e Allahut ndaj nesh është në raport të drejtë me bindjen tonë ndaj Tij.

Njeriu ka nevojë për edukim. Prandaj në periudha të ndryshme janë dërguar profetë pikërisht për të edukuar njerëzit. Profeti ﷺ është dërguar pikërisht në një periudhë kur dominonte injoranca totale. Shoqëria ku erdhi Profeti ﷺ ishte një shoqëri me kushte ekonomike më të vështira se kapitalizmi sot. Humanizmi pothuajse nuk ekzistonte fare dhe ndërgjegjja kolektive pothuajse ishte zhdukur. Atëherë, si e futi Profeti ﷺ një shoqëri të tillë në Islam? Si i edukoi Profeti ﷺ ata dhe si arriti të krijojë një shoqëri model për gjithë njerëzimin? Si u bë vrasësi i Hamzait ﷺ një musliman shembullor? Si u bënë aq të mëshirshëm ata njerëz që varrosnin për së gjalli vajzat e tyre pa asnjë lloj mëshire? Prej këtu duhet t'i qasemi zgjidhjes së problemit!

“Pa dyshim, ata që lexojnë Librin e Allahut, falin namazin dhe japin fshehtazi apo haptazi nga ajo që u kemi dhënë Ne, mund të shpresojnë në një fitim që nuk do të humbasë. Allahu do t'ua plotësojë atyre shpërblimin dhe do t'ua shtojë nga dhuntitë e Tij. Me të vërtetë, Ai është Falës dhe Falënderues.”

(Fatir, 29-30.)

Në periudha më të hershme kanë ekzistuar sisteme si kapitalizmi, socializmi dhe të ngjashëm me to, por të gjithë janë zhdukur.



MBUROJA E DEVOTSHMËRISË PËRBALLË SISTEMIT EKZISTUES

Pyetje: Është krijuar ideja se sistemi ekzistues është i fuqishëm; e tejkalon njeriun. Si mund t'i mbrojë njeriu vlerat e veta përballë një sistemi kaq dominues dhe ndikues?

Osman Nuri Topbash: Kjo është e mundur vetëm përmes devotshmërisë. Dashuria për Allahun dhe frika ndaj Tij janë mburoja më e madhe e besimtarit. E vetmja mënyrë për të mbrojtur veten nga çdo gjë e dyshimtë kudo qoftë ajo, është devotshmëria. Besimtari nuk mund të jetë aq mendjelehtë sa të shkatërrojë lumturinë e përjetshme për disa kënaqësi të përkohshme të kësaj bote. Besimtari është i gatshëm të heqë dorë nga pasuria materiale, e cila mund t'i japë një kënaqësi të përkohshme në këtë botë, në këmbim të kënaqësisë së përhershme në botën tjetër.

*“Nëse në një vend
njerëzit “e vegjël”
lëshojnë hije të gjatë,
do të thotë se aty
është duke perënduar
dielli.”*

Pra, për të ruajtur vlerat shpirtërore dhe për të mos toleruar në parimet e veta hyjnore, besimtari duhet të dijë të heqë dorë nga të mirat materiale. Edhe pse ai mund të humbasë një sasi parash, kjo nuk është asgjë krahasuar me shpërblimin që do të ketë tek Allahu. Prandaj ai është gjithmonë i qetë dhe i kënaqur prej gjendjes së tij.

“O prijës, nëse do të sundosh në disa vende, ki kujdes në këto tre pika:

Ndërsa në dorën e djathtë mban shpatën për të zhdukur padorëjtësinë, me dorën e majtë bëj bamirësi për të fituar dashurinë e Allahut. Fjalët që të dalin prej goje le të jenë më të ëmbla si mjalti. Vetëm në këtë mënyrë do të nënshtrohen të gjithë njerëzit.”

Nuk duhet të harrojmë se Allahu nuk ka kërkuar prej nesh që të jemi më të pasurit në aspektin material. Ai thjesht na ka urdhëruar të dhurojmë nga pasuria që është fituar brenda normave Islame. Prandaj si do që të jenë kushtet, jetën dhe aktivitetin tonë duhet ta ndërtojmë mbi themelet e pasurisë legjitime. Ne nuk duhet të sforcojmë caktimin hyjnor për pasurinë.

Ne duhet të japim sa të mundemi nga ajo që na ka dhënë Allahu. Nuk duhet të dobësojmë zemrën dhe të trazojmë botën shpirtërore për hir të mirëqenies

materiale. Nuk duhet ta privojmë zemrën nga qetësia që vjen si pasojë e bindjes ndaj urdhëresave hyjnore. Asnjëherë nuk duhet të harrojmë se pasuria e vërtetë dhe e përjetshme është pasuria shpirtërore...

A E DËMTON PASURIA MYSLIMANIN?

Pyetje: *Një nga kritikantët që i bëhen muslimanëve nga jashtë, është se kur pasurohen fillojnë të humbasin vlerat dhe ta shohin gjithçka të lejueshme. Virusi i temporanes pikësëpari prek muslimanët e pasur. Si e vlerësoni këtë opinion?*

Osman Nuri Topbash: Përgjigja më e mirë që mund t'i jepet këtyre kritikave është epoka ku islami është kuptuar dhe jetuar siç duhet. Për shembull; dy vjet të sundimit të Omer ibn Abdulazizit dhe tre shekujt e parë të Perandorisë Osmane, janë përgjigja më e mirë që mund t'i jepet këtyre kritikave. Megjithatë mirëqenia ekonomike mund të rritet, kur devotshmëria në zemra është e fortë, njerëzit nuk përfshihen nga arroganca, korracia dhe mendjemadhësia, përkundrazi, në kohën e tyre është e vështirë të gjesh të varfër për të dhënë zekatin.

Kurse në lidhje me kritikantët e brendshëm, tre shekujt e fundit të Perandorisë Osmane janë një shembull shumë domethënës. Kur shërbimi dhe entuziazmi në rrugën e Allahut dobësohet dhe në zemrat e njerëzve fillon të hyjë dashuria për këtë



botë, Allahu i privon nga begatia dhe mirësia.

Allahu i ka dhënë detyrën muslimanëve të jenë dëshmitarë e Tij në tokë, të punojnë për të lartësuar fenë Islame, të gdhendin në zemra e njerëzve të vërtetat hyjnore, të predikojnë dhe të përfaqësojnë fenë Islame me shembullin dhe modelin e tyre. Nëse kjo detyrë zbatohet siç duhet, nuk përjetohen as kriza shoqërore dhe as kriza ekonomike. Një shoqëri e tillë mëshire, megjithëse në pamje të parë mund të duket e varfër materialisht, në të nuk ndodh kurrë destabilizim shoqëror dhe krizë ekonomike.

“Fryti më i madh i besimit është mëshira. Treguesi më i mirë i mëshirës është të japësh nga ajo që ke, atij që nuk e ka.”

Sipas asaj që tregohet në një pjesë të librit të Flie Kadoune në lidhje me politikën e Anglisë për Lindjen e Mesme; në periudhën e fundit të Perandorisë Osmane, në fund të shekullit të XIX, në pjesën lindore të Anadollit kishte filluar një skamje e madhe. Për këtë arsye, anglezët dërguan atje një studiues për të përcaktuar nëse në atë zonë mund të bëjnë apo jo një operacion kundër Perandorisë Osmane. E vërteta që vuri në dukje studiuesi ishte tepër domethënëse. Në raport thuhej:

“Këtu ka skamje por jo uri! Secili kujdeset për një tjetër dhe e ndihmon atë! Për këtë arsye skamja nuk kthehet në uri. Si përfundim, është e pamundur që duke u nisur nga skamja, të bësh një operacion në kushtet e një përbërjeje të tillë sociale.”

De la Motraye thotë kështu:

“Tek turqit, edhe sikur dikujt t’i digjet shtëpia e t’i bëhet hi me gjithçka, nuk dëgjohen klithma grash e të qara fëmijësh siç ndodh me popujt e tjerë. Te njerëzit që e kanë humbur në këtë mënyrë tërë kamjen, shihet një nënshtrim dhe dorëzim i plotë tek Zoti. Ndërkaq, populli mirëbërës mbledh ndihma të mjaftueshme, disa herë edhe mbi nevojat, për t’ia rindërtuar dhe shtruar shtëpinë familjes së dëmtuar.”

Kurse Corneille Le Bryn i përshkruan kështu vëzhgimet e tij:

“Është e pamundur të mohohet se turqit janë shumë të dhënë pas ndihmës dhe bamirësisë, dhe se në këtë drejtim, kanë bërë shumë më tepër se të

Aliu ﷺ thotë: Janë dy mirësi që nuk jam në gjendje të përcaktoj se cila më gëzon më shumë.

Njëra është kur ujen një person me shpresën se do t’i plotësoj nevojën dhe kërkon ndihmë me gjithë sinqeritet prej meje.

Kurse e dyta, që Allahu më ka zgjedhur mua për t’i zgjidhur problemin atij personi. Zgjidhjen e problemit të një muslimani nuk e ndërroj as me një botë plot me flori dhe argjend.”

(Ali el-Muttaki, VI, 598/17049.)



krishterët. Kjo është dhe njëra nga arsyet kryesore që në shoqërinë osmane hasen më pak lypsarë.

...Turqit që s'kanë mundësi të ndihmojnë me para, e japin ndihmën duke punuar. Për shembull, mirëmbajnë rrugët, mbushin depot e ujërave të vendosura në pika të caktuara gjatë rrugëve, u shërbejnë si udhërrëfyes udhëtarëve, ndihmojnë në kapërcimin e ujërave të rrëmbyeshëm, të urave, etj. Dhe nga të gjitha këto shërbime, ata as nuk presin, as nuk marrin shpërblim. Edhe sikur dikush t'u propozojë disa akçe, i refuzojnë duke thënë se ndihmën e bëjnë për hir të Zotit.”

Këto janë vetëm disa shembuj tipik nga Perandoria Osmane. Ndërkohë, kur shikojmë Epokën e Lumturisë, prej secilës është ushqyer dhe ka marrë jetë qytetërimi osman, nuk konstatojmë as krizën më të vogël shpirtërore, megjithëse mundësitë materiale ishin më të pakta. Kurse sot që mundësitë materiale dhe mirëqenia ka arritur kulmin, krizat shpirtërore, sëmundjet psikologjike dhe psikike, fatkeqësisht kanë arritur nivelin e tyre më të lartë. Kjo, sepse lakmia për të fituar shumë është shndërruar në përbindësh dhe egoja është bërë e pangopur për shkak të lakmisë. Ndërsa ndihma reciproke u harrua dhe bamirësia e bujaria humbën në këtë vorbull shkatërruese.

Mësuesi ynë i nderuar, Nureddin Topçu, i cili na jepte mësim në shkollën e mesme, shpesh bënte këtë pyetje:



Cili është më i lumtur, njeriu i sotëm apo ai i djeshmi?

Më pas na tregonte me radhë se sa i lumtur ishte njeriu i djeshëm dhe sa në mjerim është njeriu i sotëm.

Prandaj, shpëtimi i shpirtit është i lidhur pazgjidhshmërisht me parimet hyjnore Islame, pavarësisht se në cilën periudhë ndodhemi...

Kur zemrat ngurtësohen për shkak të lakmisë materiale dhe bota e përtejme anashkalohet, duke përfutur edhe nga boshllëku legjislativ, njeriu shndërrohet në një qenie që nuk njeh as drejtësi, e as mirësi, por mendon vetëm të rrëmbejë pasuri për vete pa ndonjë qëllim të caktuar. Mjafton të hedhësh një vështrim në botë për të evidentuar këtë që thamë. Sa padrejtësi dhe luftëra bëhen sot vetëm për të siguruar pasuri dhe pushtet! Me një bombë rrënohen njerëz të pafajshëm, fëmijë, kafshë dhe bimë. Nuk ka më as mëshirë, as dhembshuri. Çfarë qytetërimi mund të ndërtojë një shoqëri që i ka duart me gjakun e njerëzve të pafajshëm.

Shkurtimisht, duke qenë larg vlerave shpirtërore, kapitalizmi e ka shndërruar pasurinë materiale në idhull...

*Ebu Bekri  thotë:
"Nëse imani qëndron
vetëm në xhami,
e nuk pasqyrohet
jashtë në jetën e përditshme, pasuria do
të bjerë në dorë të
koprracëve, arma në
dorë të frikacakëve,
autoriteti në dorë të
të dobëtëve. Atëherë,
gjendja përkeqësohet."*



QËNDRIMI ISLAM PËRBALLË KAPITALIZMIT

Pyetje: Kapitalizmi është një rrymë globale. Socializmi, i cili për një kohë konkurroi me kapitalizmin, dështoi. Ndërkohë, kapitalizmi këtë e proklamoi si fitore. Përflitet se i vetmi sistem që mund ta konkurrojë kapitalizmin, është Islami, sepse në të ka një botëkuptim, ka një stil jete. Dhe kjo është pikërisht ajo për të cilën ka nevojë njerëzimi. Njerëzit përpiqen të sulmojnë Wall Street... Revolta të ngjashme ka edhe në Europë... Edhe në Turqi janë vënë re përpjekje të tilla; si për shembull në rastin e 1 Majit ku muslimanët bashkuan forcat me të majtën për t'iu kundërvënë kapitalizmit. A mund të kemi një sistem Islam përballë makinerisë së kapitalizmit? A mund të idealizohet pikëpamja e Ebu Dherrit në këtë çështje?

Osman Nuri Topbash: Së pari duhet të kuptojmë që Islami nuk mund të bashkohet me asnjë pikëpamje tjetër. Kjo është e pamundur. Në komunizëm pasuria është kolektive, ndërsa në kapitalizëm është



individuale. Pra, kauza e të dyve është e njëjtë. Ata thjesht kanë kontraditë për sa i përket ndarjes së pasurisë. Kurse sipas Islamit pasuria nuk i përket as individit, as shoqërisë, por Allahut. Prandaj Islami nuk mund të krahasohet me asnjë sistem tjetër.

Bukuria dhe madhështia e Islamit vjen pikërisht nga kjo. Përpjekja për ta miksuar me një sistem nje-rëzor, është shenjë e indiferencës dhe dobësisë.

Në lidhje me këtë indiferencë, Rumi na jep një shembull të bukur:

Allahu ka krijuar në det të gjithë gjërat e nevojshme për peshkun, por atë e kap meraku për karremin e grepit që vjen nga jashtë. Gjithë ai peshk nuk e shikon grepin, por tërhiqet marrëzisht mbas një krimbi në majë të grepit. E, ndërkohë që mendon të përvetësojë atë krimb, ai shkatërron jetën e vet.

Sadi Shirazi thotë:

“Nëse nuk do të ishin dhënë pas stomakut, asnjë zog nuk do të binte në kurth.”

Krahasimi i Islamit me një sistem tjetër është një dobësi. Islami është sistemi më i madh dhe më madhështor që ekziston. Burimi i tij është vetë Krijuesi i gjithësisë. Ai në asnjë mënyrë nuk ka nevojë të bashkëpunojë me një sistem tjetër për t’u zbatuar. Bashkimi me një sistem tjetër do të shkaktoje shkarjen e tij majtas ose djathtas, duke humbur nga madhështia e vet. Kurse muslimanët do të humbasin karakterin dhe identitetin.

Kur arkitekti dhe piktori i madh italian Leonardo

da Vinçi i pati shkruar një letër Bajazitit II duke i propozuar që t'i bënte projektet e xhamive dhe veprave të tjera të Stambollit, kjo gjë pati shkaktuar një gëzim të madh mes vezirëve të institucionit *Kubealltë*. Mirëpo Bajaziti II i cili karakterizohej nga një mendësi mistike e hollë dhe e thellë, duke e hedhur poshtë këtë propozim, u pati thënë kështu vezirëve:

“Po qe se e pranojmë këtë propozim, në vendin tonë ka për të sunduar një arkitekturë si imitacion i arkitekturës kishtarë për sa i përket stilit dhe frymës, kurse arkitektura jonë islame nuk do të zhvillohet dot dhe nuk do të fitojë individualitet!”

Imam Shafiu thotë:

“Njeriu që është dhënë pas kësaj bote, mund të sëmure edhe njeriun më të shëndetshëm. Kurse Imam Gazaliu thotë: afërsia mentale me jo muslimanët shndërrohet në afërsi shpirtërore e cila bëhet shkak për vdekjen shpirtërore.”

Kjo pikëpamje shpreh horizontin e një muslimani të mençur, të zgjuar dhe të ndjeshëm. Ashtu siç pati ndodhur që pas Bajazitit II, tokat Islame të zgjeroheshin në njëzetekatër milion kilometra katrore, edhe arti Islam arriti majat. Në sajë të kësaj mendësie, fryma dhe shpirti Islam u gdhendën dhe

u fiksuan në gjeometri dhe u sendërtua vargu i monumenteve të papërsëritshme si Sulejmania që do ta ruajnë vlerën gjer në kiamet!

Islami nuk ka nevojë për proteza. Të pretendosh që islami ka nevojë për proteza, është tregues i injorancës ndaj Islamit.

E njëjta gjë vihet re edhe me rrymën e histor-

cizmit. Edhe ata dëshirojnë t'i bashkëngjisin Islamit një sërë rrymash bashkëkohore.

Shkurtimisht, besimtari duhet të ruajë me përpikëri ndjeshmërinë Islame dhe duhet të respektojë në maksimum parimet e Islamit të vendosura në të gjitha fushat e jetës...



PËR TË PARANDALUAR EROZIONIN SHPIRTËROR...

Pyetje: *Siç e përmendët më lart, historicizmi buron nga një dobësi intelektuale. Ata, rregullat Islame i kufizojnë vetëm për një kohë të caktuar. Tani jemi në një kohë tjetër thonë. Ata e paraqesin kapitalizmin si domosdoshmëri e qenësishme. Një person që është i kujdesshëm ndaj adhurimeve fillon të bëhet merak për vepërimtarinë ekonomike. Është krijuar përshtypja se kundërshtimi i kapitalizmit nuk po bëhet siç duhet. Çfarë mund të bëhet për të parandaluar erozionin shpirtëror?*

Osman Nuri Topbash: Së pari duhet të theksojmë se historicizmi është tërësisht i gabuar. Urdhëresat dhe ndalesat në Islam janë përcaktuar sipas natyrës së pandryshueshme të njeriut. Këto rregulla janë për gjithë kohët dhe vendet, të afta t'i japin zgjidhje të gjitha problemeve që mund t'i dalin njeriut. Prandaj ato nuk vjetrohen kurrë dhe nuk shfuqizohen. Ato e ruajnë gjithmonë përsosmërinë për të përballuar të gjithë nevojat e njeriut. Të pretendosh



se një pjesë e rregullave kuranore kanë qenë vetëm për një periudhë të caktuar kohe, është shumë e rrezikshme. Ky pretendim çon në blasfemi.

Nga ana tjetër, shthurja e historicizmit ka shkuar deri atje sa t'i atribuojë Allahut dobësi. Saherë që ka ndryshuar struktura e shoqërisë, Allahu ka dërguar profetë, dhe bashkë me ta edhe ligje sipas nevojës. Kurse Profeti ynë është i fundit i të dërguarve të Allahut. Parimet dhe ligjet që ka sjellë ai janë të vlefshme dhe të afta të zgjidhin të gjitha problemet e njerëzimit deri në ditën e kijametit. Të mendosh të kundërtën e kësaj, është devijim dhe shkarje e plotë nga Islami. Nuk ka lajthitje më të madhe se të pretendosh që e njeh krijesën më mirë se sa vetë Krijuesi. Madje, kur këtë përpiqesh ta bësh me mendjen dhe arsyen që të ka dhënë vetë Zoti, tregon se deri ku mund të arrijë lajthitja njerëzore. Atyre që bien në një gjendje të tillë duhet t'u kujtojmë ajetin kuranor:

*“Zilia nuk lejohet
veçse ndaj dy
personave: Atij që
Allahu i ka dhënë
pasuri dhe ai e
shpërndan atje ku
duhet dhe atij që
Allahu i ka dhënë
urtësinë dhe ai gjykon
me të dhe ua mëson
të tjerëve.”*

(Muttefekun alejhi)

Thuaju: “Vallë, a do ta njoftoni Allahun për fenë tuaj, ndërkohë që Ai di gjithçka që përmbajnë qiejt dhe Toka?! Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.” (Huxhurat, 16.)

Mos vallë, një pjesë të Librit (Teuratit) e besoni, kurse pjesën tjetër e mohoni?! Cilido prej jush

që vepron kështu, do të ndëshkohet me poshtërim në këtë jetë, ndërsa në Ditën e Kiametit do të dërgohet në dënimin më të ashpër. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja.

(Bekare, 85.)

Në një hadith ku i Dërguari i Allahut ﷺ, bën të ditur karakterin mrekullues të Kuranit dhe se kjo cilësi e tij do të vazhdojë të ekzistojë përjetësisht, thuhet:

“Kurani është një fjalë hyjnore që e shpëton njeriun përballë çdo intrige që mund t’i ngjasë, që përmban informacione për popujt e kaluar, për gjendjen e popujve pasardhës dhe konkluzione mbi ngjarjet që do të ndodhin mes njerëzve. Ai e ndan të vërtetën nga gënjeshtra dhe të drejtën nga e shtrembra, e nuk është i kotë. Ai deklaron se Zoti e shkatërron njeriun e mendjemadh që e braktis atë, dhe që e shmang nga rruga e drejtë njeriun i cili kërkon orientim jashtë tij. Ai është litari i fortë i Allahut, është përkujtim i urtë, udhë e drejtë dhe njerëzit e kapur pas tij, kurrë nuk bien në udhë të shtrembër. Kush flet me të kurrë nuk gabon dhe dijetarët nuk ngopen asnjëherë prej tij. Ai s’e humbet kurrë freskinë për shkak të përsëritjes dhe vetitë e tij mrekullore që e hutojnë njeriun kurrë nuk mbarojnë. Ai është një Kuran të cilin kur e kanë dëgjuar xhinët, janë mahnitur dhe kanë thënë:

“... me të vërtetë ne dëgjuam një Kuran që të mahnit!” (el-Xhin, 1.)



Njerëzit që flasin me anë të tij, thonë të vërtetën, njerëzit të cilët konkludojnë me anë të tij, konkludojnë saktë dhe sillen drejt, njerëzit që e zbatojnë atë shpërblehen dhe njeriu i ftuar tek ai gjen udhën e drejtë!” (Tirmidhi, Fedailu'l-Kur'an, 14; Darimi, Fedailu'l-Kur'an, 1)

Pas kësaj paranteze të rëndësishme, kthehemi përsëri tek tema kryesore. Së pari, muslimanët duhet të nënvizojnë fort këtë parim:

Islami nuk thotë: “Fito si të fitosh, pastaj bëj bamirësi. Por thotë; fito vetëm pasuri hallall”

Allahu nuk kërkon prej besimtarit përtej mundësive që ai ka realisht. Ne jemi përgjegjës për atë që mundemi.

Kurse rasti i Ebu Dherrit është i kufizuar vetëm me disa persona. Nuk është një rast që mund të aplikohet në gjithë shoqërinë. Allahu në mbi 200 vende në Kur'an urdhëron për bamirësi. Besimtari duhet të prodhojë dhe ndërtojë fabrika në mënyrë që të arrijë të bëjë bamirësi. Pa fituar nuk mund të bësh bamirësi. Ajo që duhet të bëjë muslimani është të fitojë pasuri hallall, të mos e shpërdorojë pasurinë, të mos jetë dorështrënguar dhe të bëjë një jetë modeste.

Në punën e tij duhet të respektojë të gjithë rregullat dhe normat Islame. Nuk duhet të shkelë të drejtën e punëtorit, nuk duhet të fitojë mbi kurrizin e tij, nuk duhet të përdorë femra dhe reklama të

Aliu ﷺ thotë:

“Kur të jeni të varfër jepni lëmoshë, në mënyrë që Allahu t'u japë begati në pasuri.”

(Nehxhul Belaga)

pahijshme për të rritur fitimin.

Në ajetin 64 të sures Isra tregohet se shejtani i bëhet njeriut ortak në pasuri dhe pasardhës. Fatkeqësisht sot, shejtani është bërë ortak në fitimin e pasurisë. Ndërtohen komplekse me pishina, vetëm për t'i shitur më shtrenjtë, duke i shndërruar vendbanimet në një vend plazhi. Kjo sjell një rrënim shpirtëror për familjet që jetojnë aty. Për të fituar sa më shumë dhe sa më shpejt, njeriu bën lloj-lloj hilesh.

Madje, ai ka arritur deri aty, sa të ndërhyjë edhe në gjenet e kafshëve dhe bimëve për të rritur fitimin. Në ushqime hedhin substanca që zgjasin jetën e ushqimit, por që janë të dëmshme për shëndetin. Në këtë mënyrë, jeta ekonomike ka dalë krejtësisht nga binarët normal.

Fatkeqësisht, edhe besimtarët e kanë humbur ndjeshmërinë në lidhje me jetën ekonomike duke

Profeti ﷺ thotë:

"Do të vijë një ditë kur njeriu nuk do të shohë si ke ka fituar pasurinë halla apo haram."

(Buhari, Buju, 7)

mos pasur kujdes se ajo që fitojnë është hallall apo haram. Ndërsa disa të tjerë, megjithëse e dinë që është haram, shkelin me vetëdije normat hyjnore me pretendimin se nuk ka mbetur mënyrë legjitime për të fituar pasuri.

Shumë muslimanë që përpiqen të respektojnë normat Islame në jetën individuale, kur vjen puna në veprimtarinë tregtare, i neglizhojnë normat Islame. Për shembull; shumë lehtë ia japin dyqanin me qira dikujt që do të hapë një biznes i cili bie në

kundërshtim me normat Islame. E harrojnë hadithin që thotë se; kush bëhet shkak për një të mirë, është sikur e ka vepruar vetë atë dhe kush bëhet shkak për një të keqe, është sikur e ka vepruar vetë atë...

Pastaj, i njëjti musliman e konsideron këtë pasuri të fituar si të pastër. Fatkeqësisht, ky fenomen është shumë i përhapur në ditët tona.

Por, pasuria që vjen nga qiraja e një dyqani që ka aktivitet jashtë normave Islame, nuk mund të jetë e pastër. Prandaj muslimani duhet të tregojë kujdes në të gjitha aspektet për mënyrën se si e fiton pasurinë. Muslimani nuk duhet ta japë dyqanin me qira dikujt thjesht se ai paguan më shtrenjtë. Por duhet të ketë kujdes se për çfarë do ta përdorë edhe ai që e merr me qira...

Fatkeqësisht, sot pasuria po ndotet me mënyra të tilla dhe të ngjashme me të. Prandaj, në jetën e biznesit, muslimani duhet të veprojë sikur është duke ecur në një zonë të minuar.

*Një gjë që është haram të merret
është haram edhe të jepet. (Mexhele)*

*Nëse diçka është haram të merret, të hahet
ose të pihet është haram të jepet ose të shitet.*

NË ISLAM NUK EKZISTON MENTALITETI: FITO SI TË FITOSH...

Shumë firma përdorin reklama që nxisin epshin për të tërhequr klientë. Pastaj e ngushëllojnë veten duke thënë; të fitoj shumë për të dhuruar shumë. Të tillë njerëz janë të shumtë në ditët tona. Këta janë në një sprovë të rëndë me pasurinë...

Për të arritur një qëllim të lejuar, Islami përdor mënyra të lejuara. Një qëllim jo i lejuar nuk mund të arrihet me mënyra të lejuara. Edhe kjo është një nga çështjet më delikate të Islamit.

Madje, Profeti ﷺ nuk toleronte në çështjet e fesë as në kushtet më të vështira.

Për të predikuar Islamin, Profeti ﷺ nuk ka përdorur asnjë mënyrë, të cilën nuk e ka aprovuar Allahu i Lartmadhëruar. Në lidhje me këtë, mund të përmendim luftën e Bedrit:

Siç e dimë, në luftën e Bedrit numri i myslimanëve ishte sa një e treta e numrit të idhujtarëve.



Gjatë rrugës për në fushën e betejës, Profeti ﷺ, bashkë me Aliun dhe Ebu Lubaben , përdorën të njëjtën deve, duke udhëtuar me radhë. Dy idhujtarë prej Medinës, që erdhën nga pas, e arritën ushtrinë dhe dëshiruan që të luftonin përkrah myslimanëve. Profeti i Allahut ﷺ, i pyeti:

- Ju dolët bashkë me ne për udhë?

Idhujtari, që quhej Hudejb, u përgjigj:

- Jo!

Profeti ﷺ, tha:

- Atëherë kthehuni! Ne nuk kemi nevojë për ndihmën e një idhujtari!..

Hudejbi nguli këmbë duke thënë:

- Unë njihem nga gjithë fisi im për trimëri dhe bëma.

Profeti ﷺ, tha:

- Jo, më parë bëhu mysliman, pastaj lufto!

Pak më vonë, Hudejbi erdhi përsëri dhe i kërkoi të njëjtën gjë. Mirëpo përgjigjja nuk ndryshoi. Ky veprim i vendosur i Profetit ﷺ, duke e ditur gjendjen e ushtrisë së tij përballë ushtrisë së idhujtarëve, ndikoi thellë në shpirtin e Hudejbit. Më në fund, Hudejbi, me një emocion të papërshekrueshëm, deklaroi se u bë mysliman. Profeti ﷺ, i cili u gëzua jashtë mase, tha:

- Tani bëj çfarë të duash!

Profeti ﷺ asnjëherë nuk ka përdorur një mjet



jo legjitim për të arritur një qëllim legjitim. Pra Profeti ﷺ nuk ka thënë fitoni si të doni pastaj bëni bamirësi...

*“Bujaria është një virtyt shumë i mirë që asnjëherë nuk duhet braktisur.
Por bujaria nuk mund të bëhet nga qesja e dorës.” (Jusuf Has Haxhib, Kutadgu Bilig)*

NJË KUJTIM NGA GARAUDY

Në këtë pikë dëshiroj t'ju përcjell një histori që ka ndodhur në Stamboll, pak a shumë njëzet a tridhjetë vite më parë: Ish Sekretari i Partisë Komuniste të Francës, Roger Garaudy, kishte ardhur në Stamboll për një konferencë në Pallatin Jëlldëz, e cila u zhvillua me pyetje-përgjigje. Gjatë kësaj konference ai u pyet:

“Ju, një herë e një kohë ishit komunist. Madje, një komunist që mund të përmbliidhte nga fillimi deri në fund komunizmin dhe të gjitha mendimet e Marksit. Ndërsa tani jeni bërë mysliman. Përse ishit i krishterë katolik, përse ishit komunist dhe përse tani jeni mysliman?”

Ai tha: “Unë kam qenë katolik. Shkova në Amerikë për shkollim. Atë kohë monopolet dhe korporatat nuk e di se sa ton grurë digjin e sa ton qumësht derdhnin! Dhe këtë e bënë vetëm që të mbanin të gjithë tregun nën monopolin e tyre. Kjo mizori dhe barbari më ngjalli një revoltë për brenda dhe më shtyu drejt komunizmit. Me kalimin e kohës, pashë që edhe komunizmi ndërtonte ndërgjegje pa shpirt. Prandaj mendova të ndërtoj



një urë me katolicizmin, e kështu t'i jap shpirt komunizmit. Por as kjo qasje nuk më dha rezultat dhe mbeta bosh. Më vonë, për mua u nxor urdhri: “të qëllohet!”. Mirëpo, një ushtar më toleroi dhe unë ia mbatha.

Ngaqë isha sociolog, u bëra kureshtar të dija se përse ky ushtar më la të ikja. Shkova e gjeta dhe e pyeta: «Përse më le të ikja, ndërkohë që për mua kishte dalë urdhri “të qëllohet”?»

Ai u përgjigj: «Unë jam mysliman! Nuk e di se çfarë ke bërë ti dhe përse donin të të vrisnin. Por nuk desha të bëhem vegël e tyre. Prandaj të tolerova dhe ti ia mbathe.»

Deri atëherë unë pandehja se Islami ishte fe fisesh. U bëra kureshtar dhe, ngaqë isha edhe ekonomist, së pari fillova nga ekonomia: Çfarë është kamata? Sepse në komunizëm kamata është e ndaluar, për shkak se është një sistem abuzimi. Kështu më shtyu kureshtja të dija se çfarë është kamata në Islam.

Por, ngjarja me Bilalin ma shoi këtë kureshtje. Bilali i solli hurma të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ai i pa ato dhe e pyeti: «*Bilal! Ku i ke marrë këta hurma?*»

Ai u përgjigj: «Ne kishim ca hurma jocilësore. Prandaj dhamë dy masa prej tyre dhe morëm një masë nga këto (hurma të mira) që t'i hante i Dërguari i Allahut.»

Pas kësaj i Dërguari i Allahut ﷺ, tha: «*Mos! Ky këmbim është i njëjtë me kamatën. Kujdes mos veproni kështu!*»

Më pas tregoi një rrugëzgjdhje: «Nëse dëshiron të marrësh hurma të mira, shiti ato që ke, pastaj me ato para bli hurma të mira.» (Buhari, Vekale, 11.)

Aty kuptova se i Dërguari i Allahut ﷺ nuk lëshonte aspak pe në çështjen e kamatës. Për rrjedhojë, kjo ngjarje më bëri të hulumtoj në lidhje me Islamin në tërësi.

Ndërsa po studioja se çfarë është ekonomia në Islam u përballa me jurisprudencën e mahnitshme të Ebu Hanifes. Çfarë botëkuptimi juridik! Kjo më qetësoi dhe më orientoi...

Por sot, mund të them se për fat të keq bota Islame nuk e njeh mirë juristin me famë botërore, Ebu Hanifen! Unë jap mësim në lidhje me botëkuptimin juridik të Ebu Hanifes edhe pse sapo jam bërë mysliman.

“Ata që marrin fajde, do të ringjallen (në Ditën e Gjykimit) si ai që djalli e ka çmendumur me preken e vet, sepse ata thonë se tregtia është njëlloj si kamatën. Porse Allahu e ka lejuar tregtinë dhe e ka ndaluar kamatën. Ai të cilit i vjen këshilla nga Zoti i tij dhe i shmanget kamatës, le ta mbajë atë që tashmë ka fituar dhe fati i tij është në duart e Allahut. Ndërsa ata që i kthehen kamatës sërish, do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.

(Bekare, 275.)



SHEMBUJ NGA IMAM EBU HANIFE

Pyetje: *Meqenëse prekët Ebu Hanifen pak më sipër dhe duke qenë se ai ishte një jurist i madh i cili njëkohësisht është angazhuar edhe me tregti, a mund të na thoni diçka në lidhje me ndjeshmërinë e tij në jetën tregtare?*

Osman Nuri Topbash: Ebu Hanife ishte një person i pasur që merrej me tregti. Por për shkak se merrej edhe me dituri, punët e tregtisë i kryente nëpërmjet ortakut të tij. Ndërsa vetë ai kontrollonte nëse tregtia bëhej brenda kushteve të hallallit apo jo. Aq i përpiktë ishte në këtë çështje, sa që njëherë, kur e kishte dërguar ortakun e tij Hafs bin Abdurrahman për të shitur një copë, i kishte thënë:

“O Hafs, malli ka këto e këto të meta. Këto ia thuaj edhe myshterit dhe mallin shite me këtë çmim të lirë!”

Hafsi e shiti mallin me çmimin e caktuar nga Imami, por harroi t’i tregonte myshterit të metat e tij. Kur e mësoi këtë, Ebu Hanife e pyeti Hafs bin Abdurrahmanin:



“A e njeh myshterium që bleu copën?”

Pasi Hafsi i tha se nuk e njohte, imami, nga frika se mos fitimi hallall do të përzihej me fitimin haram, tërë fitimin e nxjerrë nga shitja e mallit e ndau si sadaka. Ja, pra, ky devocioni i tij i solli bereqet të madh tregtisë së tij materiale e shpirtërore, pasi në çdo rast ai kujtonte fjalën që Profeti ﷺ i kishte thënë Amrit:

“O Amër! Sa i mirë është malli i drejtë për personin e drejtë!” (Ahmed bin Hanbel, Musned, IV 197 202),

Kujdesi për hallall dhe haram është shumë i rëndësishëm për pastërtinë e mallit që na është dhënë amanet. Mbi këtë do të japim llogari në Ahiret.

Është e mrekullueshme sjellja e tij për të mos u ndotur nga kamata. Ai nga frika se mund të krijohet kamatë nuk ka qëndruar as në hijen e pemës së huamarrësit.

Është e domosdoshme t'i tregohet vlera e mallit një tregtari që nuk e di. Të përfitosh nga padituria, papërvoja dhe mos reagimi i tij, është një mashtrim. Ata që në shpirt kanë frikën ndaj Allahut dhe përpjekjen për të fituar kënaqësinë e tij, janë

Profeti ﷺ thotë: Dy persona që bëjnë tregti me njërit tjetrin kanë të drejtë ta kthejnë mallin për sa kohë që nuk janë ndarë nga njëri-tjetri. Nëse kanë bërë tregti të pastër do të kenë begati, në të kundërt, nëse kanë fshehur mangësitë e mallit atëherë nuk mbetet më begati.

(Buhari, Buju, 19.)

tepër të përpiktë në këtë drejtim. Imam Adhami e pyeti një grua për çmimin një veshje mëndafshi të cilën e kishte sjellë për t'ia shitur.

Gruaja i kishte thënë:

-100 dërhëm o imam.

- Ai e kishte kundërshtuar dhe i kishte thënë:

- Jo, kjo kushton më tepër...

Gruaja e habitur i kishte shtuar 100 dërhëm. Imam Adhami përsëri nuk e kishte pranuar. Gruaja kishte shtuar edhe 100 dërhëm, më pas edhe 100 dërhëm të tjera, por Imam Adhami i kishte thënë:

- Jo, kjo kushton më tepër se 400 dërhëm.

Gruaja pa ngurrim i ishte përgjigjur:

- O Imam! Po talleni me mua?

Pas kësaj imami i kishte thënë gruas që të thërriste një person që e njihte këtë punë që t'ia tregonte vlerën e vërtetë të asaj cope. Ai e kishte përcaktuar vlerën e mëndafshit për 500 dërhëm

Profeti ﷺ thotë:

"Pasuria më e pastër është pasuria që ka këto cilësi:

- Kur shitësi dhe blerësi nuk gënjejnë.

- Kur u besohet nuk tradhetojnë.

- Kur blejnë një mall nuk flasin keq për atë mall.

- Kur shesin nuk e teprojnë në lëvdimin e mallit të tyre.

- Kur kanë marrë hua nuk e vonojnë.

- Kur kanë dhënë hua nuk i bëjnë presion huamarrësit."

(Bejhaki, Shuab, IV, 221.)

dhe më pas Imam Adhami e kishte blerë atë mëndafsh me atë çmim. Ai e dinte se të ndahesh nga e drejta, të mbulosh mangësitë e mallrave, e mbi të gjitha të mos kesh kujdes në peshë, janë veprime që e çojnë njeriun në përfundime të dhimbshme.

Kjo ndjeshmëri e Ebu Hanifes është tregues i përpjekjes për të pasuar Profetin ﷺ dhe shokët e tij. Ndoshta burimi i kësaj sjellje të Ebu Hanifes është kjo ngjarje që ka ndodhur në Epokën e Lumturisë.

Xherir ibn Abdullah dëshironte të blinte një kalë. Një shitës kuajsh i ofroi kalin që pëlqeu për 500 dirhem. Abdullahu refuzoi ta merrte me këtë çmim, sepse mendonte se vlera e kalit mund të ishte 600 dirhem madje edhe 800 dirhem. Por shitësi nuk ishte shumë i aftë në vlerësimin e mallit që shiste.

Shitësi i drejtohet Abdullahut, duke i thënë:

- Përse e ngrite çmimin në 800 dirhem, kur kishe mundësi ta merrje për 500 dirhem?

Xheriri dha këtë përgjigje mbresëlënëse:

- Ne i kemi dhënë fjalën Profetit ﷺ, për të mos bërë dredhi në tregti. (İbn-i Hazm, el-Muhal-la, Egjipt 1389, IX, s. 454 vd.)

Omeri ﷺ thotë: Mos shikoni namazin dhe agjërimin e personit, por shikoni nëse flet të vërtetën, nëse e ruan amanetin që i kanë lënë, dhe nëse tregon kujdes në hallall dhe haram kur bëhet fjalë për pasurinë e kësaj bote."

Asnjë e mirë nuk mund të vijë nga fitimi ku shkelen normat Islame. Përkundrazi, në ditën e gjykimit do të ndodhemi përballë një përgjegjësie të madhe.



NËSE MBLIDHEN 100 TË NJERËZ TË PASUR

Pyetje: *Fatkeqësisht sot vejmë re një dukuri shumë interesante. Shumë njerëz që shkelin rregullat Islame në jetën ekonomike, përpiqen t'i legjitimojnë veprimet e tyre. Për shembull, ata mendojnë se bamirësitë e bëra pastrojnë aktivitetin prej ku fiton para. Nëse mblidhen 100 të pasur dhe i tregojmë atë që ju prekët pak më lart, çfarë do të thonë, sepse pjesa më e madhe e fitimi të tyre përbëhet nga aktivitete të tilla. Si e ngushëllojnë veten ata?*

Osman Nuri Topbash: Ata ngushëllohen duke thënë unë bëj bamirësi. Në fabrikën time punojnë 3000 punëtorë të cilët sigurojnë jetesën e familjes. Por islami nuk na urdhëron që të fitojmë pasuri në rrugë jo legjitime për të ushqyer njerëzit. Rizkun e jep Allahu.

Profeti ﷺ ka thënë: “Sikur ju të mbështeteshit tek Allahu me një mbështetje të vërtetë, Ai



do t'ju furnizonte juve siç furnizon zogun që del nga foleja i uritur, e kthehet i ngopur." (Tirmidhi, Zuhd, 33.)

Allahu në ajetin kuranor thotë: **"Sa krijesa ka që nuk e mbajnë dot veten me ushqim! Allahu u jep atyre dhe juve! Ai dëgjon dhe di gjithçka."**

(Ankebut, 60.)

Allahu u tregon muslimanëve se nuk duhet të shqetësohen për sigurimin e jetesës. Allahu urdhëron të fitojmë prej aktivitetit hallall dhe prej saj të bëjmë bamirësi.

*Allahu im!
Mbështetem tek ti
nga dituria që s'jep
dobi, nga zemra
që s'rrëqethet, nga
nefsi që s'ngopet
dhe nga lutja që nuk
pranohet!"* (Muslim,

Dhikr, 73.)

Kur i hedhim një sy të parëve tanë të devotshëm, përballemi me tablo shumë mbresëlënëse. Për shembull, njëherë, një njeri i devotshëm nuk ishte ulur për të ngrënë në një sofër, duke thënë se ajo kishte hije dyshimi. Të pranishmit i thanë: Ushqimi është hallall.

Ndërsa ai tha: Ushqimi është hallall, por ai që e ka gatuar ka qenë i zemëruar.

Ashtu si atomi që kur shpërthen përhap radion, i cili depërton edhe hekurin, edhe ndikimet shpirtërore janë shumë të rëndësishme.

Për shembull, kur Profeti ﷺ, po shkonte në haxhin e fundit, kaloi pranë vendit ku u shkatërrua

ushtria e Ebrehesë dhe tha se aty kishte rënë dënimi i Allahut. Për këtë arsye, ai i urdhëroi besimtarët të kalonin me nxitim prej aty.

Po ashtu, në luftën e Tebukut, kur kaluan pranë vendit ku kishte jetuar populli i Themudit, Profeti ﷺ tha: Mos pini ujë këtu!

Kur shokët i thanë që mbushëm ujë dhe bëme brumë me atë ujë.

Profeti ﷺ tha: Ujin derdheni kurse brumin jep-jani deveve!

Kaq i kujdesshëm dhe i ndjeshëm është Islami ndaj ushqimit. Në fakt, një nga pesë pyetjet që do të bëhen në ditën e gjykimit është edhe: Si e fitove dhe si e shpenzove pasurinë?

Profeti ﷺ thotë: "Në Ditën e Kijametit (gjykimit) asnjë rob nuk do të hedhë qoftë edhe një hap, pa u pyetur se ku e ka shpenzuar jetën, çfarë ka bërë me diturinë e vet, si e ka fituar dhe si e ka shpenzuar pasurinë dhe ku e ka mplakur trupin e tij!

(Tirmidhi, Kijamet, 1/2417.)



SA PJESË E PASURISË SHKON PËR BAMIRËSI?

Sa pjesë të pasurisë japin ata që thonë; të fitoj shumë, që pastaj të jap shumë.

Këtu dëshiroj të përcjell një kujtim.

Në kohën e mbretit Fajsal, ministri i Haxhit erdhi për të takuar babain tim. Ato ditë po rikonstruktohej Ravza. Babai i thotë: Sa mirë që Ravza po hapet! Muslimanët do të jenë më rehat.

Hasan Kutbi, pasi u mendua pak tha:

Gjëja më e vështirë është përdorimi i parasë... Unë personalisht e përjetoj këtë shqetësim. Unë, - tha ai, përdorimin më të mirë të pasurisë e kam parë tek Osmanët. Ata kanë lënë vepra që i gëzojnë brezat njëri pas tjetrit. Sa pjesë të pasurisë shpenzojnë sot muslimanët për vendet e shenjta?

“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë.” (Ali Imran, 92.)



Babai im më pati treguar fletoren e zekatit duke më thënë:

Kjo është fleta e zekatit, ndërsa kjo fleta e bamirësisë. Egoja vazhdimisht e mashtron njeriun. Një bamirësi të vogël ia tregon si të madhe. Prandaj zekatin dhe bamirësinë shënoje në vende të ndryshme. Dhe, pasuria që jep për bamirësi le ta kalojë shumë herë pjesën e zekatit.

Zekatin e japim, por zekati është një shumë e vogël. Nuk shpëtohet lehtë, thjesht duke dhënë zekat!

Nëse e do të Profetin ﷺ, atëherë duhet të përpiqesh të jetosh ashtu si ka jetuar ai. Nëse dëshiron që në ditën e kijametit të jesh me Profetin dhe shokët e tij, duhet ta rregullosh gjithë jetën tënde sipas mësimëve të tij. Adhurimi, morali dhe veprimtaria ekonomike duhet të jetë sipas mësimëve Islame. Veprat e tyre janë shembull për ne. Allahu na urdhëron që sjelljet tona të rregullohen sipas shembullit të Profetit ﷺ.

“Allahu në Kuran thotë: Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.” (Ahzab, 21.)

Si mëshirë e Allahut për ne, të gjithë informacionet për sjelljet e Profetit ﷺ dhe shokëve të tij, janë ruajtur në formë të përsosur dhe me detaje. Personaliteti dhe biografia e të Dërguarit të Allahut, përbën kulmin më të lartë të sjelljeve, përfshirë këtu

edhe shfaqjet apo dukuritë që nuk mund të kuptohen vetëm nga mendja njerëzore. Allahu i Lartë e ka krijuar atë si shembullin e moralit më të mrekullueshëm. Kjo është edhe arsyeja që Allahu i Lartë e ka përcjellë këtë qenie në të gjitha shkallët e jetës, duke filluar që nga “fëmijëria jetime” si faza e parë për sa i përket vuajtjeve brenda shoqërisë njerëzore, dhe e ka ngritur atë deri në pikën më të lartë për sa i përket fuqisë dhe kompetencës, pra, në shkallën e drejtuesit të shtetit dhe të profetit. Çdokush, në çfarëdo lloj pozicioni të jetë, mund të marrë prej tij shembujt më të mrekullueshëm të sjelljeve dhe të mundohet t'i realizojë ato sipas fuqisë dhe aftësisë së tij.

*“O tregtarë! Pa dyshim që në shitje-blerje
përzihen gënjeshttra dhe betimi, prandaj
ju futni në tregti dhënien e sadakasë!”*

(Ahmed, IV, 6; Ebu Davud, Buju, I/3326.)



ISLAMI ËSHTË SI NJË FARMACI

Islami është si një farmaci që ka të gjitha ilaçet për çdo sëmundje. Por fatkeqësisht, në këtë farmaci sot ka hyrë kapitalizmi dhe socializmi. Nëse në një gotë me ujë të pastër hedh një pikë ujë të ndotur, ajo e ndot gjithë gotën. Në rastin tonë, nuk priset pastërtia e Islamit; ai e ruan pastërtinë, por turbullohet bota shpirtërore e muslimanëve. Dhe ky është një problem i madh. Sot, kapitalizmi dhe socializmi kanë hyrë në këtë farmaci...

Njerëzit e urtë kanë thënë se, nëse dëshiron të shpëtosh; harro dy gjëra dhe mos harro dy të tjera:

1. Mos harro Zotin! A është i kënaqur Zoti me gjendjen dhe sjelljet tona? Nëse Profeti ﷺ do të ishte tani këtu, a do të buzëqeshte për veprimet e mia? Muslimani duhet të jetë në një gjendje të tillë vetëkontrolli për të mbrojtur veten.

“...që grumbullon pasuri dhe e ruan, duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm! Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese. E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese? Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort, i cili depërton deri në zemrën e njeriut.”

(Humeze, 2-7.)

2. Mos harro vdekjen dhe botën tjetër. Mos harro daljen para Allahut. Mos e harro ditën e madhe ku do të thuhet: **“Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!”** (Isra, 12.)

Kurse dy gjëra harroji:

1. Harro mirësitë që ke bërë, në mënyrë që mos të të japin egoizëm dhe vetëpëlqim, sepse një e mirë e vogël, mund të duket shumë e madhe dhe fillon të lëvdosh veten për mirësitë që bën. Por në

fakt, nuk është se ke bërë ndonjë gjë të madhe. Në vend që të mburresh, ti duhet të falënderosh Allahun që të ka dhënë mundësi të bësh bamirësi. Duhet të falënderosh Allahun që të ka zgjedhur ty për këtë punë, dhe kjo duhet të të bëjë sa më modest. Kjo ka qenë gjendja e Epokës së Lumturisë, e cila përbën shembullin kryesor në stilin e jetës sonë.

O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t’ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin.

(Munafikun, 9.)

2. Harro të këqijat që të janë bërë, me qëllim që urrejtja dhe zemërimi të mos çelin sythanë zemrën tënde. Allahu thotë:

“...a nuk doni që t’ju falë Allahu?...” (Nur, 22.)

Falja e Allahut është e lidhur ngushte me faljen që i bëjnë njerëzit njëri-tjetrit.

Pra, për të shpëtuar, duhet të harrojmë dy gjëra dhe të mos harrojmë dy të tjera.

SI NDIKON DISIPLINA MISTIKE NË SPROVËN E PARASË?

Pyetje: *Si e vlerësoni rolin e mistikës në jetën ekonomike? Sa mund të ndikojë mistika në edukimin e njerëzve në një gjendje të tillë?*

Osman Nuri Topbash: Mistika në kuptimin e saj të vërtetë, e ul në minimum rrezikun që vjen prej një jete ekonomike të cilën e trajtuam më sipër. Kjo, sepse dobësia kryesore e njeriut në sprovën me pasurinë, është bindja ndaj egos duke devijuar nga rruga e Allahut.

Kurse mistika është disiplina e edukimi të egos, mistika është një luftë e vazhdueshme kundër egos.

Mistika është një disiplinë purifikimi. Ajo përpiket të largojë dhe pastrojë zemrën nga çdo gjë që e largon prej Allahut. Mistika bën të mundur arritjen e përkushtimit në të gjitha nivelet.

Mistika është një disiplinë edukimi në të gjitha fushat e jetës, jo vetëm në lidhje me pasurinë. Ajo është një disiplinë për të mbajtur zemrën të zgjuar dhe larg indiferencës.



Mistika është arti që bën të mundur fitimin e dashurisë dhe miqësisë ndaj Allahut. Mistika është aftësia për të ruajtur ekuilibrin në të gjitha situatat që të ofron jeta. Përmes saj, njeriu arrin të kapërcejë vështirësitë dhe t'i harrojë ato.

Ambienti ku lulëzon kapitalizmi është vendi ku mjaftueshmëria, modestia dhe thjeshtësia pothuajse nuk ekzistojnë. Në një mjedis të tillë lulëzon ambicia dhe lakmia për të fituar sa më shumë. Prandaj, është e domosdoshme të zhvillohet një edukim mistik për të bërë të mundur mposhtjen e këtyre ndjenjave negative. Kjo arrihet me një mbështetje tek Allahu, me një mbështetje që nuk arrin në dembelizëm. Mjaftueshmëria është një pasuri e madhe që bën të mundur të shpëtosh nga prangat e lakmisë dhe ambicies.

Faruddin Attari thotë:

“Si mund ta bëjë bota të pasur një njeri që nuk ka ndjenjën e mjaftueshmërisë?”

Në një periudhë kur ndjenjat dhe sjelljet negative janë përhapur shumë, kjo gjendje nuk mund të përballohet thjesht me dhënie fetvaje për problemin në fjalë, por duhet një proces edukimi që bën të mundur shpëtimin përfundimtar nga problemet. Ruajtja nga një mjedis i tillë negativ mund të arrihet vetëm përmes devotshmërisë. Në këtë aspekt, mistika është një mundësi shumë e mirë. Rëndësia e mistikës po bëhet gjithnjë e më e evidente. Nëse një person që merret me tregti nuk kalon përmes një edukimi mistik, është i destinuar

të bjerë pre e kurtheve të kapitalizmit, duke rrënuar në këtë mënyrë veten e tij dhe shoqërinë.

Kurse një besimtar që ka arritur një pjekuri shpirtërore, arrin ta ruajë veten edhe kur fiton, edhe kur humbet pasuri materiale, sepse për një besimtarë të tillë, më shumë se fitimi apo humbja, e rëndësishme është të mos humbë sprovën me pasurinë.

Gjatë gjithë historisë, mistika ka luajtur një rol të rëndësishëm në jetën shoqërore dhe politike. Mistika ka qenë një mburojë e fortë përballë veseve dhe shthurjes që janë shfaqur në shoqëri. Madje, në gjë e tillë ka ndodhur edhe në periudhat e pushtimit të tokave Islame nga ana e të huajve. Në periudha shumë të vështira të historisë, muslimanët kanë marrë frymë përmes mistikës dhe kanë arritur të shërojnë plagët e përballojnë vështirësitë.

Në mistikë, tregtari ka gjetur gjithmonë çlodhje dhe prehje nga lodhja dhe shqetësimet e ditës në aktivitetin e tij ekonomik dhe tregtar. Përfitime të tilla prej mistikës, sot janë shumë të kufizuara. Për të përfituar prej mistikës, sot duhet shumë më tepër përpjekje individuale.

Gjatë historisë mistika ka shërbyer si një qendër rehabilitimi. Ajo ka qenë një institucion që shërben-

Kini mëshirë për këto tre persona: Për atë që nga i pasur bëhet i varfër, për atë që nga një njeri me autoritet bëhet një person që nuk e respekton askush dhe për dijetarin që mbetet midis injorantëve.

te jo vetëm për edukim shpirtëror por edhe për të kontribuar në përmisimin e gjendjes materiale, ekonomike dhe shoqërore. Ky institucion ka qenë një derë e hapur për të gjithë ata që përballeshin me probleme të ndryshme gjatë jetës. Edhe fjala e Rumiut: “Eja, çfarë do që të jesh, përsëri eja!” duhet kuptuar si një thirrje shpëtimi për të pashpresët dhe të dëshpëruarit.

Të gjitha këto janë sjellje sipas traditës profetike. Profeti ﷺ saherë që arrinte një fitore apo sukses thoshte:

Osmani ﷺ ka thënë:

“Mendimi për këtë botë është errësi për zemrën, kurse mendimi për ahiretin është dritë për zemrën.”

“O Zot! Jetë e vërtetë është vetëm jeta e ahiretit”

Me këtë, ai ka dashur t'i ndërpresë rrugën egoizmit, mendjemadhësisë dhe mburrjes. Po ashtu, saherë që përballej me një vështirësi thoshte përsëri:

“O Zot! Jetë e vërtetë është vetëm jeta e ahiretit”

Këtë e bënte për t'i treguar besimtarëve që nuk ia vlen të biesh në dëshpërim dhe pesimizëm për të mirat e përkohshme të kësaj bote. Në këtë mënyrë, ai i ka lënë ymetit një recetë për të ruajtur ekuilibrin dhe qetësinë përballë çdo gjendje.

Kur njeriu largohet nga shpirtërorja dhe e neglizhon atë, ai është i destinuar të përfundojë në kriza të ndryshme qoftë i pasur, qoftë i varfër. Në kamje, njeriu duhet frenuar, kurse në skamje duhet qetë-

suar dhe ngushëlluar. Prandaj, njerëzit kanë nevojë për institucionin e mistikës, qofshin në kamje apo në skamje. E në fakt, edhe pasuria, edhe varfëria janë sprovë për njeriun. Madje, sprova e pasurisë është më e madhe se ajo e varfërisë, sepse në pasuri egoja llastohet, kurse në varfëri, për shkak të dobësisë, mundësia që të afrohet tek Krijuesi është më e madhe. Më e mira e të mirave është të mos ankohemi për caktimin e Allahut...

*Imam Gazaliu thotë:
"Aftësi e vërtetë, është
të durosh në kamje."*



NËSE ISLAMI JETOHET NË SHOQËRI

Pyetje: *Me çfarë mund të kontribuojë mistika në një shoqëri ku jetohet Islami?*

Osman Nuri Topbash: Mistika synon ta çojë besimin në nivelin e “Ihsanit” pra në nivelin ku personi vepron sikur e shikon Allahun, sepse ai është i ndërgjegjshëm se edhe pse ai nuk e shikon Allahun, Allahu e shikon atë. Besimtari, përmes mistikës në çdo moment jeton me vetëdijen se është nën vëzhgimin hyjnor.

Shumë njerëz kujtojnë se janë para Zotit vetëm në namaz. Por në fakt, ne duhet të jemi të vetëdijshëm se jemi para Zotit në çdo kohë dhe çdo vend. Duke qenë se mistika kultivon mbikëqyrjen hyjnore dhe vetë-llogarinë e njeriut, atëherë besimtari tregon një kujdes më të madh ndaj urdhëresave dhe ndalesave hyjnore. Kjo, nga ana e saj siguron një mjedis më të përshtatshëm për t’u zbatuar Islami siç duhet.



SPROVA E PASURISË DHE VARFËRISË

Pyetje: Ekziston opinioni se muslimanët e hershëm sprovoreshin me varfëri kurse tani po sprovohen me pasuri. Si e vlerësoni këtë opinion? Është gjynah të jesh i pasur?

Osman Nuri Topbash: Siç e shprehëm edhe më lart, pasuria dhe varfëria është çështje caktimi hyjnor. Të dyja janë sprova të vështira të kësaj bote. Allahu i sprovon njerëzit me të dyja.

Por pasuria është një sprovë më e rëndë, sepse përdorimi i pasurisë për qëllime sublime, është privilegj i zemrave që kanë arritur një nivel të caktuar pjekurie shpirtërore. Shumë njerëz mendojnë se e përdorin pasurinë, por në të vërtetë është pasuria që i përdor dhe i drejton ata. Madje, ata janë të pavetëdijshëm për këtë fakt.

Profeti ﷺ ka thënë:
Betohem në Allahun se unë për ju nuk kam frikë varfërinë. Unë kam frikë se bota do të shtrohet para jush, ashtu siç u është shtruar popujve të mëparshëm, e ju do të garoni ashtu siç garuan ata për këtë botë dhe bota do t'ju shkatërrojë ashtu siç i ka shkatërruar ata."

(Buhari, Rikak, 7; Muslim, Zuhd, 6.)

Sot, kapitali përcakton sjelljet e individëve. Kapitali është bërë promotor i sjelljes njerëzore. Në fakt, njeriu duhet të jetë përcaktues, jo pasuria! Njeriu nuk duhet të jetë skllav i pasurisë por pronar i saj! Dhe kjo bëhet e mundur vetëm duke iu bindur plotësisht urdhrave të Krijuesit të gjithësisë.

Shembullin tipik të kësaj gjendje e gjejmë tek profetët, sahabët dhe të dashurit e Allahut. Ata nuk e kanë pasur qëllim pasurinë, por e kanë përdorur atë si mjet për tu afruar tek Allahu dhe për të fituar dashurinë e Tij.

Në historinë e njerëzimi nuk ka ekzistuar njeri më i pasur se Sulejmani عليه السلام, por ai asnjëherë nuk e konsideroi paranë dhe pasurinë qëllim në vetvete. Për këtë arsye, ai meritoi nga ana e Allahut lëvdatën: **“Sa rob i mirë!”**

Po ashtu, edhe Ibrahim i عليه السلام, megjithëse ishte shumë i pasur, ai për asnjë moment nuk shfaqti shenja neglizhence ndaj Krijuesit dhe për hir të dashurisë së madhe ndaj Zotit bënte vazhdimisht bamirësi. Si rezultat i këtyre virtyteve të larta, ai u quajt “Mik i Allahut”.

Pra, nuk është problemi në angazhimin me punët e dynjasë, problemi qëndron kur punët e kësaj bote bëhen pengesë për adhurimet dhe shkak për

“Njerëz, të cilët nuk i pengon shitblerja për të përmendur Allahun, të cilët falin namazin, japin zekatin dhe kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuar.”

(Nur, 37.)

ftohjen e marrëdhënieve me Zotin. Është gabim që mjetin ta bësh qëllim në vetvete! Nëse dora punon për pasuri dhe zemra është vazhdimisht me Zotin, atëherë prej pasurisë nuk ka asnjë të keqe.

Prandaj, opinionin se: “Për qetësi shpirtërore duhet varfëri” është krejtësisht i gabuar. Islami, në asnjë mënyrë nuk e ka ndaluar njeriun të pasurohet. Dy nga pesë shtyllat e Islamit, siç janë Zekati dhe Haxhi, janë adhurime që për t’i kryer duhet një sasi e caktuar parash të fituara në mënyrë legjitime.

Hadithi profetik thotë:

“Tregtari fjalëdrejtë, i ndershëm dhe i besueshëm është bashkë me profetët, besnikët dhe dëshmorët!” (Tirmidhi, Buju, 4.)

Ashtu si në të kaluarën, edhe sot, njerëzit në nevojë dhe të varfër kanë nevojë për ndihmën e të pasurve që e fitojnë pasurinë në rrugë legjitime. Asketizmi nga kjo botë është një çështje shpirtërore dhe në asnjë mënyrë nuk është një braktisje apo tërheqje e plotë nga punët e kësaj bote. Detyra e besimtarit nuk është të heqë dorë nga kjo botë, por të mos bëhet rob i saj.

S’ka dyshim se, ditën e kiametit, tregtarët do të ringjallen si mëkatarë përveç atyre që frikësohen nga Allahu, që bëjnë të mira dhe janë të besës, të drejtë e të ndershëm!”

(Tirmidhi, Buju, 4/1210.)

“DYNJAJA ËSHTË INDIFERENCË NDAJ ZOTIT”

Kush ka një jetë të varfër si rezultat i përcaktimit hyjnor, por shpirtërisht shkon pas dëshirave të egos, nuk mund të quhet njeri asket, sepse asketizëm nuk do të thotë të jesh i detyruar të mjaftohesh me pak, por ta ruash zemrën dhe shpirtin me dëshirë dhe me bindje nga skllavëria e kësaj bote.

Sa bukur e ka përshkruar dhe përkufizuar i Dërguari i Allahut ﷺ përkorësinë:

“Të jesh asket i kësaj bote, nuk do të thotë të ndalosh lejuarën dhe të braktisësh të pasurinë!.. Asketizmi i vërtetë i kësaj bote, është besimi më shumë tek ajo që ndodhet tek Allahu, se sa tek ajo që ndodhet tek ti dhe t’i konsiderosh shpërblimet që do të marrësh si pasojë e (durimit të) ndonjë fatkeqësie që të bie, më të dashura se sa ato që do të humbësh si pasojë e asaj fatkeqësie.” (Tirmidhi, Zuhd, 29/2340.)

Sa bukur e shpreh Rrumiu këtë gjendje:

Jetë do të thotë të jesh plotësisht i vetëdij-



shëm për Allahun dhe jo të kesh para, copa të bukura, gradë dhe fëmijë.

Një nga robërit e dashur të Allahut, Muhamed Parisa, i cili ishte edukuar nga dora e Shah Nakshibendit, rrugës për në Haxh, u kthye në qytetin e Bagdadit ku rastisi një argjendar në moshë të re, të cilit i ndriste fytyra. Kur e pa të riun që ishte duke tregtuar vazhdimisht me myshterijtë e tij, mendoi se ai po shpenzonte shumë kohë në punët e kësaj bote. Për këtë arsye u mërzi dhe tha me vete:

“Sa keq! Atë e paska kap-luar angazhimi me këtë botë, pikërisht në moshën kur mund të kryejë adhurime në mënyrën më të bukur!” Mirëpo, kur e vëzhgoi me vëmendje, vuri re se zemra e të riut që shiste flori, ishte gjithmonë bashkë me Allahun, sepse ai e përkujtonte Atë vazhdimisht. Prandaj, duke e lavdëruar të riun tha:

“MashaAllah! Duart në këtë botë, por zemra me Allahun!..

Kur Muhamed Parisa arriti në Mekë, pa një të moshuar mjekërbardhë, i cili qante me përgjërime i kapur pas mbulesës së Qabes. Në fillim, kur e pa të moshuarin që po i përgjërohej Allahut duke qarë, tha me xhelozi:

“Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë, ndërsa jeta e botës tjetër, është pikërisht jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin!”

(El-Ankebut, 64.)

“Ah sikur edhe unë të mund t’i përgjërohesh Allahut kështu duke qarë.” Mirëpo, kur i dëgjoi me vëmendje lutjet e të moshuarit, kuptoi se gjithë ato të qara, ishin për realizimin e dëshirave të kësaj bote të përkohshme. Kjo e mërziti shumë zemrën e tij të butë.

Edhe Mevlana, duke e përngjarë njeriun e kësaj jete me një anije që noton në det thotë:

- *Kur deti është poshtë, anija i mbështetet atij, por nëse dallgët fillojnë të hyjnë në anije, e shkatërrojnë atë.*

Jahja bin Muadh 
thotë:

“Arifi (i dituri) në të djathtë pat marrë ahiretin, në të majtë botën, ndërsa shpirtin e pat kthyer drejt Zotit. Tashmë atë nuk mund ta preokuponte asgjë tjetër përveç Allahut.”

Me të vërtetë nuk mund të mohohet se ekziston rreziku që zemra të përfshihet plotësisht nga mirësitë e kësaj jete dhe për rrjedhojë të dobësohet lidhja e saj me Allahun. Çdo besimtar është paralajmëruar për këtë rrezik në Kuran me termin “fitne”, e cila përdoret për “pasuri” dhe për “fëmijë”. Nisur nga kjo, ne duhet

të ruajmë zemrën nga indiferenca, ndërkohë që mërrimi me problemet e botës. Nëse zemra nuk ruhet nga dashuria për këtë botë, edhe gjëja më e vogël është e papranueshme. Profeti  ka thënë:

“Shijet e ëmbla të botës janë dhimbjet e Ahiretit, ndërsa dhimbjet e botës në aspektin e provimit janë shijet e ëmbla të Ahiretit.” (Hakim Mustadrek v. IV

Varfëria dhe pasuria nuk janë e mirë apo e keqe. Në fak, kjo duhet vlerësuar sipas pozitës së personit. Në historinë e Islamit është folur me lavdërim për “fukarai sabirin” (të varfrit durimtarë) dhe “agnijai shakirin” (të pasurit falënderues). Madje njerëz janë bërë subjekt i tregimeve legjendare mësimdhënëse.

Kurse tek njerëzit indiferentë, edhe pasuria, edhe varfëria bashkohen në të njëjtin mëkat. Edhe varfëria, edhe pasuria krijojnë kushte të barabarta për të hapur dyert e mëkateve nëse nuk ekziston gjendja e pjekur shpirtërore.

Profeti ﷺ thotë: *“O Zot strehohem tek Ti nga varfëria që më bën të harroj Ty dhe nga pasuria që më bën arrogant.”*

Pra, edhe varfëria e madhe që të çon në kundërshtim të urdhëresave hyjnore, edhe pasuria që të çon në arrogancë, janë të barasvlershme në këtë aspekt.



PAK SHPENZIM, SHUMË BAMIRËSI

Pasuria e kësaj bote është një mirësi e madhe për ata që dinë ta përdorin sipas normave kuranore dhe traditës profetike. Një pasuri e tillë është një mbretëri e përhershme. Një musliman i pasur mjaftohet me pak për vete dhe bën shumë bamirësi. Shembuj të tillë nga sahabët janë Ebu Bekri, Osman ibni Affan, Abdurrahman ibni Avf, etj., ndërsa prej dijetarëve janë Ebu Hanife, Ubejdullah Ahrar, etj.

E kundërta e kësaj është ai që zhytet në shpërdorim dhe koprraci, që e çojnë atë në fatkeqësi dhe sprova të vështira. Shpenzimi pa kriter dhe koprracia janë fatkeqësi të mëdha për njeriun. Faroni u bë arrogant me pasurinë e kësaj bote, aq sa arriti deri aty sa të thoshte: “Unë jam zoti juaj”. Mirëpo, kjo pasuri e përkohshme e kësaj bote nuk e shpëtoi atë nga mjerimi në botën e përjetshme.

Edhe Karuni u shkatrua në këtë mënyrë. Kur ishte i varfër, Karuni ishte një dijetar asket që interpretonte më mirë se çdo kush tjetër Teuratin. Por kur u bë i pasur, ai filloi të shquhej për arrogancë,



shpenzim dhe teprim në çdo gjë. Madje, edhe kur e këshilluan: “Mos u bë arrogant sepse Allahu nuk i do arrogantët!”, ai nuk ia vuri veshin, por u mbështet tek pasuria e tij. E si përfundim, ai u fundos me gjithë pasurinë e vet në thellësinë e tokës. Në një hadith, Profeti ﷺ thotë:

“Bota është e ëmbël dhe pamja e saj është e hijshme. Padyshim që Allahu do t’u japë drejtimin e botës dhe do të shikojë se si do të silleni; çfarë punësh do të bëni. Prandaj kini kujdes nga bota!”
(Muslim, Dhikër, 99.)

Pra, nëse është i devotshëm, njeriu mund ta ruaj drejtimin edhe nëse është i pasur, edhe nëse është i varfër.

Bujaria është një pemë mes pemëve të Xhennetit, që i ka shtrirë degët e saj në këtë botë. Kush kapet pas një prej degëve të saj, ajo e shpie në xhennet. Ndërsa koprracia është një pemë nga pemët e Xhehenemit, e cila i ka shtrirë degët e saj në këtë botë. Kush kapet për njërës prej këtyre degëve, ajo e zvarrit për në Xhehenem!..”

(Bejhaki, Shuabu'l-Iman, VII, 435)

KRITERI I SHPËRDORIMIT DHE LUKSIT

Lëmosha u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t'i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Allahu i di ato.

(Bekare, 273.)

Pyetje: *Një nga kritikantët që bëhet muslimanëve sot, është se po shpenzojnë pa kriter dhe po shkojnë çdo ditë e më shumë pas luksit. Ata shpenzojnë shumë për të blerë, shtëpi, veshje, e makina të shtrenjta. Natyrisht, këto janë gjëra të domosdoshme, por problemi është se muslimanët janë përfshirë nga pasioni për luks. A ka ndonjë kriter në shpenzim? Për shembull, supozojmë se unë jam një njeri shumë i pasur; cili është kriteri dhe kufiri i shpenzimeve të mia, kufiri përtej të cilit nuk duhet të kaloj? Ose formuluar pak më ndryshe: Unë jam një musliman që i zbatoj me përpikëri përgjegjësitë e fesë. Pas kësaj, a jam unë i lirë të shpenzoj si të dua?*

Osman Nuri Topbash: Po ta shohim në aspektin e devotshmërisë, ky kufi është ndryshe; po ta shohim në aspektin e lejueshmërisë është ndryshe. Së pari, duhet të kuptojmë se gjithë pasuria është e Allahut. Vetëdijesimi për këtë fakt, është i domosdoshëm! Pasuria që na është dhënë është një amanet. Ata që janë më të varfër, janë përgjegjësi e të pasurve. Unë kam, ai nuk ka. Atëherë, unë duhet të plotësoj edhe nevojën e atij që nuk ka. Kultivimi i këtij virtyti tek besimtari dhe shndërrimi tij në pjesë të karakterit të tij është një domosdoshmëri. Kjo është edhe mënyra më e mirë për të përdorur pasurinë.

Zemra e besimtarit duhet të jetë si një skaner shpirtëror. Ai duhet ta kuptojë menjëherë nga pamja e jashtme se cili ka me të vërtetë nevojë. Duhet ta dëgjoni nevojtarin. Kurse atë që nuk vjen për shkak të krenarisë duhet ta gjesh ti. Ashtu siç kërkon dyqan në dyqan për të blerë diçka, ashtu duhet të kërkosht edhe për nevojtarët. Pasuria është e Allahut, neve thjesht na është dhënë si amanet. Si mund ta përdorësh si të duash një gjë që nuk është e jotja? Kjo konsiderohet tradhti ndaj amanetit.

Për sa i përket pyetjes se a ka liri muslimani

*“Engjëlli i vdekjes
e zgjon njeriun
indiferent nga gjumi
(i indiferentizmit)
për t’ia marrë
shpirtin. Atëherë,
ai njeri mjerohet
për shqetësimet që
hoqi në këtë botë
për një pasuri që
në të vërtetë s’ ishte
e tij, dhe pendohet
një mijë herë... Por
tashmë është shumë
vonë, çdo gjë ka
mbaruar!...”*

(Xhelaleddin Rumi)

të shpenzojë si të dojë pasi të përmbushë të gjitha detyrimet fetare...

Muslimani nuk ka një liri të tillë!.. Besimtari është i lirë brenda normave që i ka përcaktuar feja. Nëse del jashtë normave fetare, ai bëhet rob i egos. Siç u shprehëm edhe më lart; sado të fitojë, besimtari duhet të shpenzojë për vete aq sa ka nevojë, jo më tepër! Pjesën që i mbet duhet ta shpenzojë në atë mënyrë që të jetë kapital për botën tjetër.

"Nuk është nevojtar ai që shëtit derë më derë dhe rehatohet me dy-tre hurma dhe me dy-tre kafshata ushqim. Nevojtar i vërtetë është ai që nuk ka të ardhura as për veten e tij, që nuk i jep akush sadaka megjithëse e dinë se ai është nevojtar dhe që nuk lyp gjë prej ndokujt tjetër."

(Buhari, Zekat, 53.)

Shpenzimi mbi nevojë është shpërdorim, ndërsa shpenzimi vetëm për vete është koprraci. Allahu na ka urdhëruar të qëndrojmë sa të mundemi larg nga këto dy cilësi, duke na urdhëruar të jemi bujarë, gjë e cila është rruga e mesme. Ajeti kuranor thotë:

"Të pyesin se çfarë duhet të japin si lëmoshë. Thuaju: "Tëp-ricën!" Ja, kështu jua shpjegon Allahu shpalljet e Tij, që të mund të mendoni." (Bekare, 219.)

Profetit ﷺ i takonte një e pesta e plaçkës së luftës; po të dëshironte, mund të bënte një jetë mjaft të pasur me të. Por ai zgjodhi të bëjë një jetë të thjeshtë dhe askete, duke u mjaftuar me plotësimin e nevojave kryesore. Në këtë mënyrë, ai u bë shembull për "të pasurit falënderues". Kur në shtëpinë e tij nuk kishte gjë tjetër përveç ujit, duronte dhe falënderonte

duke u bërë shembull i “të varfrit durimtar”. Ai ishte shembull dhe model praktik në çdo aspekt.

Një ditë, sahabët e nderuar po flisnin për këtë botë pranë Profetit ﷺ. Në lidhje me këtë, i Dërguari i Allahut ﷺ tha:

“A nuk dëgjoni, a nuk dëgjoni? Të jetosh thjeshtë është prej besimit! Të jetosh thjeshtë është prej besimit!” (Ebu Davud, Terexhxhul, 1/4161; Ibn Maxhe, Zuhd, 4)

Përsëri, Profeti ﷺ duke dashur të përcaktojë kufijtë e nevojës tha:

“Hani, pini, vishuni dhe jepni sadaka, pa u zhytur në shpërdorim dhe mburrje.” (Buhari, Libas, 1.)

“Të hash çdo gjë që të shkon mendja, është shpërdorim.” (Ibn Maxhe, Et’ime, 51.)

Kjo gjendje, e cila në gjuhën popullore quhet “grykësi”, është e ndaluar nga feja jonë. Po ashtu, në hadithin e mësipërm nënkuptohet edhe fakti se; të kesh mundësi, nuk do të thotë që është e lejuar të konsumosh çfarë dhe sa të duash.

Aliu ؑ thotë: “Njerëzit e uritur në shoqëri shtohen në raport të drejtë me shpërdorimin e të pasurve.”

Jahja ibn Muadhi, pa një jurist të dhënë shumë pas kësaj bote dhe i tha:

“Pasuria e pakët për të cilën mund të falënderosh, është më e mbarë e më e dobishme se pasuria e shumë për të cilën nuk mund të falënderosh!..”

(Taberi, Xhamiul Bejan, XIV, 370, 372)

“O njeri i ditur!

Sarajet tuaja u ngjajnë pallateve mbretërore të perandorëve Romakë,

Shtëpitë tuaja, u ngjajnë shtëpive të mbretërve të Persisë,

Rezidencat tuaja, u ngjajnë rezidencave të Karunit,

Portat tuaj u ngjajnë portave të Talutit,

Rrobat tuaja, u ngjajnë rrobave të stolisura të Xhalutit

Mënyra e jetës suaj, i ngjan mënyrës së jetës së shejtanit,

Përfundimi juaj, i ngjan përfundimit të mohuesve,

Administrimi juaj, i ngjan administrimit të Faranit,

Gjykatësit tuaj, u ngjajnë gjykatësve të dhënës pas dynjasë,

Ndarja juaj nga kjo botë, i ngjan vdekjes së kohës të xhahilijetit.

Atëherë, ku është Islami?”

Konsumi i tepërt, grykësia, luksi dhe mania për t'u dukur, të cilat janë disa nga sëmundjet morale më problematike të kohës sonë, përbëjnë një mënyrë jetese që brezi i sahabëve nuk e ka njohur kurrë. Kjo, sepse ata jetonin me vetëdijen se: “Vendbani mi tjetër pas vdekjes, është varri”. Ata asnjëherë nuk harronin se një ditë do të jepnin llogari për çdo gjë.

“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!” (Tekathur, 8.)

Islami nuk mund ta pranojë kurrë mentalitetin:
“Fito si të duash, shpenzo si të duash!”

Sepse muslimani është përgjegjës për të ardhmen e gjithë botës. Sahabët, ngaqë ishin të vetëdijshëm për këtë përgjegjësi, u përhapën në katër anët e botës, nga Kina në Semerkand, nga Shami në Afrikë. E gjithë kjo përpjekje, u bë për të çuar në vend përgjegjësinë.

Ne mund ta dimë sasinë e caktuar që duhet të japim si zekat, por ne nuk mund ta dimë borxhin e falënderimit që kemi ndaj Allahut për mirësitë e tjera jo materiale. Prandaj, sahabët bënë një jetë plot përpjekje dhe sakrificë deri në fund të jetës së tyre. Ata nuk pushuan për asnjë çast në rrugën për të kryer misionin e tyre dhe nuk u lodhën në këtë rrugë. Nga 100.000 mijë sahabë që morën pjesë në hutben e lamtumirës, vetëm 20.000 janë varrosur në Meke dhe Medinë; të gjithë të tjerët janë shpërndarë në katër anët e botës për të lartësuar fjalën e Allahut. Kjo duhet të na kujtojë ne përgjegjësitë tonë përballë fesë dhe njerëzimit.

“Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm.”

(Teube, 34.)



SHIKONI JETËN E SAHABËVE

Pyetje: *Thuhet që fetarët në përgjithësi janë të varfër. Kur pasurohen, a ndodh që ta humbin lidhjen me fenë?*

Osman Nuri Topbash: Fatkeqësisht kjo vjen nga që ekziston një shkëputje nga edukimi shpirtëror. Sahabët janë shembulli më i mirë për ne. Allahu na i tregon sahabët si model. A ekzistonte tek ata anashkalimi i fesë, a e përdornin ata fenë thjesht për sfond? A kishte tek ata shpërdorim? A kishte luks? A kishte koprraci? Një kokë delje që i dhurohej një sahabiu, kalohej dorë më dorë në shtatë familje të varfra. Gjithsecili preferonte tjetrin para vetes, derisa koka e deles mbërrinte përsëri tek personi që e kishte dhuruar herën e parë. Çfarë edukimi!? Çfarë morali shembullor!? Pikërisht për këtë moral kemi nevojë sot. Për t'u bërë shembull për sahabët, shpesh herë, Profeti ﷺ ia atribuonte vetes një çështje.

Pak para se të ndërronte jetë, Profeti ﷺ i mblo-dhi sahabët dhe i tha:

“O Sahabët e mi! Kujt i kam qëlluar në shpi-



në të urdhërojë të më gjuaj në shpinë. Kujt i kam marrë mall, le të vijë të marrë mallin tim.”

Kjo, për t'i treguar sahabëve se në çfarë gjendje morale duhet të jetë muslimani. Gjithmonë duhet ta pyesim veten nëse i kemi detyrim dikujt? Si do të dalim para Allahut? A kam bërë ndonjë gabim? A i kam bërë dikujt padrejtësi? Këto janë disa pyetje për të cilat çdo musliman duhet të shqetësohet.

Ishte një skllav zezak i quajtur Mid'am i cili i shërbente Profetit ﷺ. Atë ia kishte dhuruar Rifaa bin Zejd. Në një çast, ndërsa po shkarkonte barrën e Profetit ﷺ, një shigjetë e ardhur nga një drejtim i paditur e goditi dhe i shkaktoi vdekjen.

Muslimanët i shprehën kështu ngushëllimet e tyre për vdekjen e shërbyesit të Profetit:

“O Mid'am, xhenneti të qofte i bekuar! O i Dërguari i Allahut, martirizimi i qoftë i bekuar shërbëtorit tënd!”

Kurse i Dërguari i Allahut ﷺ i kundërshtoi:

“Jo, s'është ashtu! Beto hem në Allahun, në dorën e fuqisë së të Cilit ndodhet qenia ime, se për një qilim që e mori ditën e Hajberit para se të ndahej plaçka, në këtë çast, ai është duke u djegur në flakë sipër tij!”

Muslimanët që e dëgjuan këtë, u frikësuan shumë. Një njeri i solli Profetit ﷺ një dy lidhëse këpucësh duke i thënë:

“Kush hyn në borxh me qëllim që të mos e shlyej, del para Zotit si hajdut.”

(Ibn Maxhe, sadaka, 11, 24, 10)

“O i Dërguari i Allahut! Edhe unë i pata marrë këto lidhëse para se të ndahej plaçka!”

Profeti i tha:

“Edhe për ty ka nja dy lidhëse zjarr (ndëshkim) nga zjarri i xhehenemit!” (Buhari, Ejman, 33; Muslim, Iman, 183.)

Shkurtimisht, kush bën një të mira sa një grimcë do ta shohë atë dhe kush bën një të keqe sa një grimcë do ta shohë atë.

*Besimtarët nuk duhet
ta harrojnë kurrë të vërtetën:
“Hallalli ka llogari kurse harami dënim.”*



PESHORE ARGJENDARI DHE PESHORE DRUVARI

Njerëzit e devotshëm, çdo gjendje dhe situatë e kanë peshuar me përpikmërinë e peshores së një argjendari. Në peshoren e argjendarit, edhe miligrami është i rëndësishëm. Ndërsa njësia matëse e masës së gjerë të njerëzve, është peshorja e druvarit. Fatkeqësisht, në ditët tona nuk ekziston më as peshorja e druvarit. Jeta e dhënë pas kënaqësive të kësaj bote, e ka bërë njeriun të harrojë gjithçka që ka lidhje me botën tjetër.

Një mik të Allahut e kishin pyetur se çfarë është nefsi. Ai ishte përgjigjur: “Vendose gishtin para syrit! Pra, mbylle syrin me gisht! A mund të shikosh gjë? Ja pra, ky është nefsi.” Pra një ego e papërshtetur nëpër procesin e edukimit, është një ego e verbër. Ajo është një ego që nuk e pranon përkohësinë. Madje, edhe nëse plakët, ajo përsëri nuk e pranon.

Kur ishim të angazhuar me biznesin e tregtisë, në dyqan erdhën dy gra të moshuara të cilat e thërrisnin njëra-tjetrën “Vajzë” Megjithëse në moshë,



përsëri e thërrisnin njëra-tjetrën:” Vajzë eja shikoje këtë” Edhe veshjet i kishin si të vajzave të reja. Çfarë është kjo? Është një protestë ndaj përkohësisë. Pra, kanë vendosur gishtin në sy dhe nuk shikojnë që vdekja po afron.

Është shumë interesant fakti se varrezat janë në vende sa më larg njerëzve, sepse duan ta largojnë mendjen nga vdekja. Por lumi i jetës rrjedh dhe ikën në një formë shumë të shpejtë. Ditët e jetës sonë të përkohshme, që janë të caktuara nga Vullneti Hyjnor, janë si pikat e ujit që mbushin gotën. Asnjëherë nuk duhet të harrojmë se, çdo ditë që kalon, ne përparojmë drejt pikës së fundit të jetës sonë të kufizuar, pra, largohemi një ditë nga kjo botë dhe i afrohem një ditë më shumë varrit.

Në lidhje me këtë aspekt, ky paralajmërim i imam Gazaliut është shumë domethënës:

“Bir! Supozojë se ke vdekur sot! Sa shumë që do të mërzhitesh për momentet që ke kaluar me shkujdesje përgjatë jetës! Pastaj do të thuash: ‘Ah sikur...!’ Po kjo nuk do të ketë dobi! (Sepse nuk ekziston kthimi prapa!)”

Pra aftësia, më e madhe është të mposhtësh egon...

*Tre gjëra janë
sekreti i qetësisë dhe
lumturisë:*

*“Modestia,
vetëmjaftueshmëria
dhe meditimi mbi
vdekjen.”*

MASHTRIMI PËRMES REKLAMAVE

Pyetje: *Cilat janë kriteret e domosdoshme që duhet të marrë parasysh besimtari në sprovën e tij me pasurinë? Çfarë ekuilibri kanë krijuar Profeti ﷺ dhe sahabët në jetën e tyre në lidhje me këtë?*

Osman Nuri Topbash: Sapo emigroi në Medine, Profeti ﷺ krijoi vëllazërinë midis muslimanëve. Pastaj nënshkroi kartën e njohur të Medines që rregullonte marrëdhëniet e muslimanëve me jo-muslimanët.

Një ditë, kur doli në treg për inspektim, Profeti ﷺ takoi një burrë që shiste grurë. Ai e pyeti tregtarin se si e shiste mallin.

Burri ia shpjegoi sipas mënyrës së tij. Në atë moment Profeti ﷺ futi dorën në grurë dhe pa se ishte i lagur. Më pas tha:

- Ta kishe vënë pjesën e lagur sipër që ta shohin njerëzit. Nuk është prej nesh ai që mashtron.
(Muslim, Iman 164.)



Mashtrimi më i madh sot bëhet përmes reklamave. Reklamat në përgjithësi nxisin shpërdorimin dhe përpiqen ta tregojnë produktin më të mirë dhe më cilësor sa është në të vërtetë. Nga ana tjetër, për të tërhequr sa më shumë klientë përdoren femrat si objekte joshëse. Çdo gjë është bërë ambalazh, kurse përmbajtjes nuk i jep askush shumë rëndësi.

Mallrat reklamohen dhe ekspozohen nëpër vitrina, sidomos ushqimet të cilat shumë jetimë dhe fëmijë të varfër nuk mund t'i blejnë. Në një farë mënyre, kjo do të thotë t'i hysh në hak tjetrit.

Kohë më parë, nga frika se e shikonte dikush që nuk kishte mundësi për të blerë, ushqimi nuk ekspozohej as në restorante. Po ashtu, kur blinin ushqime apo fruta, i futnin nëpër trasta të padukshme në mënyrë që të varfërit që nuk kishte mundësi për t'i blerë, të mos i mbetet

Profeti ﷺ thotë:

"Betimi rrit interesin për mallin por largon begatinë."

syri aty...

Profeti ﷺ e ka ndaluar edhe shqetësimin e fqinjit me erën e ushqimit që gatuhet. Kurse sot, njerëzit i reklamojnë dhe ekspozojnë sa më shumë mirësitë, jo vetëm në dyqane, por edhe në rrjete sociale. Mirëpo, kjo gjendje nuk ndihmon në krijimin e lidhjeve vëllazërore midis të varfrit dhe të pasurit, por vetëm sa e thellon humnerën mes tyre.

Profeti ﷺ gjatë gjithë jetës këshilloi të vërtetën dhe drejtësinë. Në fund të jetës, siç e shprehëm edhe më lart, i mbledhi shokët dhe u tha:

“O Sahabët e mi! Kujt i kam qëlluar në shpinë të urdhërojë të më gjuaj në shpinë. Kujt i kam marrë mall, le të vijë të marrë mallin tim”

Në këtë mënyrë, ai tregoi për rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut. Është shumë e rëndësishme që shpagimi me njerëzit të përfundojë në këtë botë, sepse shpagimi në botën tjetër është shumë herë më i vështirë. Është jashtëzakonisht në favorin tonë të mos dalim në ditën e gjykitimit me barrën e cenimit të të drejtave të njeriut. Në jetën ekonomike dhe tregtare, ku mundësia për t'i hyrë në hak tjetrit është më e madhe, duhet të tregojmë shumë herë më tepër kujdes.

Profeti ﷺ thotë: “Kush i ka bërë vëllait besimtar ndonjë padrejtësi në nder apo në pasuri, të hallallohet me të para se të vijë dita e kiametit, ku nuk do të ketë flori dhe argjend. Në të kundërtën, nëse ka vepra të mira, do t'i merren prej sevapeve të tij aq sa ka bërë padrejtësi. (dhe i jepet atij që i është bërë padrejtësi). Por, nëse nuk ka vepra të mira, do të merren prej gjynaheve të vëllait që i ka bërë padrejtësi dhe do t'i ngarkohen atij.” (Buhari, Mezalim, 10, Rikak, 48.)



KËTO KRITERE JANË VETËM PËR TË DEVOTSHMIT?

Pyetje: *Ekziston një mendësi, sikur këto kriteret mund të zbatohen vetëm nga njerëzit e devotshëm. Kur jepen këto shembuj, thuhet: Këto janë shumë normale për dijetarët dhe njerëzit e devotshëm. Ndërsa njerëzit e rëndomtë mund ta rregullojnë jetën e tyre edhe me anë të rregullave të tjera. Mirëpo, në fakt këto që thatë ju janë parime që duhen respektuar nga të gjithë muslimanët.*

Osman Nuri Topbash: Allahu thotë në Kuran: **“...Ruajuni Allahut! Allahu ju mëson ju...”** (Bekare, 282) Në 258 vende të ndryshme në Kuran kalon fjala devotshmëri. Ky urdhër hyjnor padyshim që përfshin të gjithë besimtarët pa asnjë përjashtim. Por zemra e njerëzve është e ndryshme.

Normalisht që bindja është e lidhur ngushtë me dashurinë. Dashuria e vërtetë është si një linjë energjitike midis dy zemrave. Një linjë të tillë dashurie krijuan sahabët me Zotin dhe Profetin ﷺ. Kjo dashuri arriti në atë nivel që sahabët të garonin me njëri-tjetrin për të përmbushur porositë e Profetit ﷺ.



Gjithsecili prej tyre, duke thënë “Të qofshin falë feta dhe pasuria ime o i Dërguari i Allahut!” përmbushnin me një dëshirë të zjarrtë porositë e Profetit ﷺ. Pra, sakrifikimin e jetës dhe pasurisë për Profetin ﷺ, ata e konsideronin si një mirësi të madhe.

Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, u tha: “Kush do t’ua dërgojë letrat mbretërve?”

Asnjëri nga shokët e tij nuk u justifikua duke thënë: “Është rrugë e gjatë; me çfarë do të iki; ata mund të më vrasin, etj.”, por kërkuan të kryenin këtë shërbim sublim me një dëshirë të zjarrtë dhe në mënyrë vullnetare.

Dashuria për Profetin ﷺ i tejkalonte dëshirat e kësaj bote. I riu i famshëm i Mekës, Musab ibn Umejr ishte nga një familje e pasur e qytetit. Parfumi që përdorte ai bëhej modë për gjithë të rinjtë. Po ashtu, edhe vajzat e dallonin nga parfumi se ai kishte kaluar diku në rrugë. Mirëpo, ai i hodhi të gjitha pas shpine këto. Për hir të dashurisë së besimit, ai i braktisi të gjitha mirësitë dhe privilegjet. Kur Omeri ﷺ e pa Musab ibn Umejrin me rroba të grisura dhe të vjetra në xhaminë e Profetit ﷺ nuk e mbajti dot veten nga lotët.

Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pa-bindur.”

(Teube, 24.)

Si është e mundur kjo? Sekreti i kësaj qëndron në njohjen e Profetit ﷺ. Ta njohësh me gjithë zemër, të përfitosh prej botës shpirtërore të Profetit ﷺ ndjekja me sinjeritet e mësimëve profetike e çon në një nivel të tillë besimtarin ku ai sakrifikon çdo gjë për parimet hyjnore. Në themel të problemeve shoqërore në botën e sotme qëndron mos njohja si duhet e Profetit ﷺ.

“Jepni në rrugën e Allahut dhe mos e hidhni në rrezik veten me duart tuaja! Dhe në çdo veprim silluni me drejtësi dhe ndershmëri se Allahu i do të drejtët e të ndershmit!”

(Bekare, 195)

Prandaj, mësimi i biografisë së tij është shumë i rëndësishëm. Biografia e tij nuk është thjesht një informacion kronologjik për jetën e Profetit ﷺ. Pra, më tepër se me mendje dhe me sy, historinë e Profetit ﷺ duhet ta lexojmë me zemër, sepse leximi i biografisë së tij me zemër, të hap horizonte të tjera. Në historinë e Profetit ﷺ do të gjejmë një panoramë gjithëpërfshirëse të jetës njerëzore; ajo do të shërbejë si një pasqyrë për të gjitha gjendjet tuaja shpirtërore.

Sot, pjesa më e madhe e sëmundjeve është me bazë psikologjike. Në krizë psikologjike gjendet edhe i pasuri, edhe i varfëri. Në periudhën e Epokës së Lumturisë nuk vërejmë asnjë fenomen psikiatrik. Asnjë sahab nuk ka shkuar tek Profeti ﷺ për t'u ankuar për krizë psikologjike, asnjë sahab nuk ka shkuar për tu ankuar për humbjen e ekuilibrit psikologjik.

Kurse sot, është mbushur plot me raste të kri-

zave psikologjike. Njerëz shumë të pasur dhe me mirëqenie të lartë materiale janë në krizë të plotë psikologjike dhe shpirtërore. Krahastuar me vite më parë mirëqenia është rritur shumë, por në raport të drejtë me këtë, janë rritur edhe rastet e sëmundjeve psikologjike dhe shpirtërore. Familja e qetë dhe e lumtur pothuajse nuk ekziston më. Divorcet janë rritur në mënyrë të frikshme. Fëmijët janë në gjendje të mjerueshme. Të rinjtë e privuar nga ngrohtësia familjare përpiqen të gjejnë ngrohtësi në vende të gabuara dhe në rrugë.

Prandaj ne kemi nevojë më shumë se kurrë për edukimin profetik; kemi tmerrësisht nevojë për dashurinë profetike. Nëse kapitali i dashurisë harxhohet në vende të gabuara, është i destinuar të përfundojë nën këmbët e njerëzve, si ato lulet që lulëzojnë anash rrugë.

Prandaj, lidhja fort pas mësimëve Islame është e domosdoshme. Sahabët, vetëm në këtë mënyrë arritën majat më të larta të botës shpirtërore.

Dashurinë për Profetin ﷺ duhet ta mbajmë gjallë dhe të freskët në zemrat tona. Nuk duhet të lejojmë që të shuhet kjo dritë në zemrat tona. Shebull konkret i kësaj dashurie është Ebu Bekri .

“Ashtu siç nuk kalbet zemra nën dhë, ashtu edhe veprat që janë prodhime të zemrës, fitojnë përjetësi. Njerëzit e zemrës, duke u dhënë vazhdimësi shërbimeve të tyre edhe në botën e varrit, vazhdojnë të jetojnë mes nesh. Jetëgjatësia e tyre është më e madhe se e atyre që janë gjallë!”

- Xhelaleddin Rumi -

Profeti ﷺ është kapitali më i madh shpirtëror që kemi. Përmes tij, ne mund t'i japim formë jetës së pëtejme. Kjo është një mirësi shumë e madhe, sepse mund të kishim lindur edhe në një shoqëri budiste. Dhe, nëse ndodhte një gjë e tillë, çfarë vlere do të kishte pasuria e kësaj bote. Kur humbet diçka materiale, njeriu mërzhitet menjëherë dhe vihet në lëvizje për ta gjetur. A e kemi ne të njëjtin shqetësim përballë humbjeve shpirtërore? Ne duhet ta ndjejmë shumë herë më tepër humbjen e mundshme shpirtërore.

Shpesh e pyes veten se sa të shqetësuar jemi për çështjen e botës tjetër? Sa të përgatitur dhe të shqetësuar jemi për frymën e fundit dhe ditën e parë në varr? Sa të përgatitur dhe të shqetësuar jemi për ditën e gjykimit? Sa të shqetësuar jemi për rrezikun e dënimit në botën tjetër?

Meditimin mbi këto pyetje e pengon protesta e egos për përkohësinë, sepse nuk dëshiron ta mendojë të përkohshmen, nuk dëshiron ta mendojë vdekjen. Egoja dëshiron ta mbajë sa më larg vdekjen. Këtë gjendje dhe perde indiference mund ta kalojmë vetëm me dhikrin ndaj Allahut. **“Zemrat gjejnë qetësi vetëm me përmendje e Allahut.”** (Rrad, 28.) Dhikri nuk duhet të bëhet vetëm me gojë, por edhe me zemër.

PROBLEMI KRYESOR ËSHTË EDUKIMI SHPIRTËROR

Pyetje: *Duke u nisur nga ato që thatë, a mund të nxjerrim përfundimin se pasuria të largon nga devotshmëria dhe të përhumbe pas kësaj bote? A mos duhet të qëndrojmë larg pasurisë?*

Osman Nuri Topbash: Paraja është si një thikë me dy tehe. Paraja, edhe mund të afrojë tek devotshmëria, edhe mund të largojë. Kjo është në varësi të gjendjes shpirtërore. Ajo që e drejton pasurinë është zemra. Si të jetë zemra, atë formë merr edhe pasuria. Pra, problemi është në zemër. Prandaj Allahu e thekson shumë rëndësinë e zemrës dhe na informon se vetëm ata që vijnë me një zemër të pastër mund të shpëtojnë. Allahu na fton në pastrimin e zemrës.

Pyetje: *Atëherë problemi i muslimanit në sprova të pasurisë buron nga mungesa e edukimit shpirtëror?*

Ibn Hazmi thotë:

“Çdo mirësi materiale që nuk të afron tek Allahut është fatkeqësi e madhe.”

Osman Nuri Topbash: Shumë e vërtetë. Na vijnë shpesh letra ku ankohen për fëmijët. Pyetja që u duhet bërë atyre prindërve, është se; çfarë i ke dhënë ti fëmijëve? Fillimisht duhet ta kërkojmë problemin në veten tonë.

Më erdhi në mendje një kujtim i dijetarit të njohur Ali Ulvi Kuruxhu. Para 50 vjetësh, vetëm 12 mijë haxhinjë shkonin në Haxh. Ngaqë numri i haxhinjëve ishte i vogël, gjenin më shumë mundësi për të krijuar komunikim me haxhinjë e ardhur nga vende të tjera. Një ditë, Ali Ulvi dhe disa shokë të tij, po qëndronin në bibliotekën e Medinës. Një nga haxhinjë i tërhoqi vërejtje një haxhiu të ardhur nga Afrika për mungesë edukate. Në këtë moment çohet kryetari i grupit nga Afrika dhe i thotë: Me çfarë të drejte e kritikon? Profeti ﷺ i dërgoi sahabët në Afrikë për t'i mësuar. A keni ardhur ju ndonjëherë në Afrikë? Këta, për herë të parë këtu kanë parë xhami. Ata janë njerëz që jetojnë në pyll, a keni ardhur ju për t'i mësuar?

Pikërisht ky është problemi. Çfarë i kanë dhënë prindërit fëmijëve, që të presin diçka prej tyre!? Prandaj duhen kuptuar dhe treguar mirë mësimet Islame. Njerëzit kanë nevojë për një shembull ideal që e jeton Islamin me gjithë qenien e tij.

Xhelaludin Rrumiu jep një shembull figurativ shumë të bukur në lidhje me atë që thamë:

“Ishte natë. Dola jashtë nga shtëpia dhe po shëtisja në livadhe. Pashë një burrë të shkretë, i cili po shëtiste me kandil në dorë.”

- Çfarë po bën tani në këtë errësirë? - e pyeta.
- Po kërkoj njeriun - u përgjigj ai.
- Mos u lodh kot. Unë braktisa vendin tim për këtë dhe përsëri nuk e gjeta. Shko në shtëpi, shko shtrihu. Po e kërkon kot, nuk do ta gjesh askund.
- Edhe unë e di që nuk do të mund ta gjej. Por më pëlqen ta kërkoj me mall. Më freskon shpirtin ideja që është ai të cilin kërkoj... - u përgjigj burri me një shikim plot trishtim.

Ky është njeriu që kërkon shoqëria sot. Shoqëria ka nevojë më shumë se kurrë për shembull ideal dhe konkret që t'i udhëheqë në përpjekjen për të dalë nga kjo krizë ku ka hyrë shoqëria.

Të gjitha virtytet dhe bukuritë janë mbledhur në personalitetin e tij të pasiq. Bota e tij shpirtërore është si një kopsht xheneti ku gjenden lulet më të rralla e të bukura dhe trëndafilat me aromën më të këndshme.

Gjithë sekreti qëndron se sa mund të përfitojmë ne nga ky kopsht xheneti. Sa e ngjashme është jeta jonë familjare, shoqërore dhe tregtare me atë të Profetit ﷺ...



MARRËDHËNIA PUNËTOR- PUNËDHËNËS

Pyetje: *Ju falënderojmë shumë, sepse na kujtuat shumë elementë të rëndësishëm të jetës. Në lidhje po me temën, çdo ditë e më shumë po flitet për shkeljen e të drejtave të punëtorit. Kur një gjë të tillë e bën një jobesimtar, e kuptoj, por ajo që nuk e imagjinoj dot, është se si mundet një musliman të shkelë të drejtat e punëtorit? Cila është e drejta e punëtorit dhe çfarë kriteri duhet të përdoret për të përcaktuar pagën e tij?*

Osman Nuri Topbash: Ne sot ndjejmë keqardhje për të varfrit, por keqardhja më e madhe duhet të jetë për punëdhënësit që i bëjnë padrejtësi punëtorit. Duhet të ndjejmë keqardhje dhe të përpiqemi t'i udhëzojmë ata. Shumë probleme sot burojnë nga punëdhënës të padrejtë.

Siç e preka edhe më sipër, nuk ka kush të drejtë t'i thotë punëtorit: Ti po ushqehesh prej meje.

Në momentin që po ndërronte jetë, Profeti ﷺ theksoi fort dy gjëra. Madje, transmetuesi thotë se Profeti i kishte ikur zëri aq shumë, saqë dëgjohej



me shumë vështirësi dhe, për t'u dëgjuar më mirë i përsëriste disa herë.

Porosia e parë ishte detyra ndaj Allahut. Namazi, Namazi, Namazi!

Kurse porosia dytë, ishte respektimi i të drejtave të atyre që kishin nën urdhra, nën shërbim. Për rrjedhojë, shumë sahabë i liruan robërit e luftës nga frika se mos u bënëin padrejtësi.

Punëdhënësi musliman duhet t'i japë punëtorit ushqimin me të cilin ushqehet vetë dhe nuk duhet ta ngarkojë me punë më tepër sa mund të bëjë. Këtë të drejtë, Islami nuk e ka vetëm për njerëzit, por edhe për kafshët. Profeti ﷺ në lidhje me të drejtat e kafshëve thotë:

“Përdorini dhe shalojini kafshët mirë e pa i lodhur dhe pastaj lërinini me kujdes që të pushojnë! Mos i bëni si vend për t'u ulur dhe biseduar nëpër rrugë! Mos i ktheni ato në podiume të bisedave tuaja nëpër rrugë e sokakë. Ka shumë kafshë, të cilat janë më të mira se ata që u hipin atyre dhe që e përmendin Allahun më tepër se ata.” (Ahmed, III, 439.)

Pyetje: *Pra, po thoni që punëdhënësi musliman duhet të jetë më i kujdesshëm në sjelljet ndaj punëtorit?*

Osman Nuri Topbash: Allahu në suren Huxhurat thotë: **“Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij.”** (Huxhurat, 13.) Është shumë interesante se shkaku i zbritjes së këtij ajeti është një skllav. Siç dihet, atëherë, sipas të



drejtës së luftës, robërit e luftës shiteshin si skllavër. Ky skllav ishte bërë musliman. Kur kishin kërkuar për ta blerë, kishte shprehur një kusht që ta linin të lirë për të falur namazin me Profetin ﷺ, kur të thirrej ezani. Për këtë shkak edhe Profeti ﷺ e shikonte gjithmonë me gëzim këtë skllav. Një ditë, ai nuk e pa më dhe e pyeti të zotin se ku ndodhej.

“Atëherë, çfarë keni që nuk shpenzoni në rrugën e Allahut, ndër-kohë që vetëm Atij i përket trashëgimia e qiejve dhe e Tokës? Nuk janë të barabartë ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar para fitores me ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar më pas. Ata kanë shkallë më të lartë, mirëpo Allahu u premton të gjithëve më të mirën (Xhennetin). Allahu e di mirë atë që bëni ju.”

(Hadid, 10)

Është i sëmurë i tha i zoti. Profeti ﷺ i tha shokëve: Hajde të gjithë të shkojmë për vizitë tek shërbëtori. Pas një kohe, përsëri nuk e pa në xhami dhe e pyeti të zotit se pse nuk po e shihte...

Është duke dhënë shpirt i tha i zoti.

Menjëherë i tha shokëve; hajde t'i shkojmë për vizitë. Profeti ﷺ nuk u nda nga shërbëtori deri sa ndërroi jetë. Kur vdiq, ai u kujdes për të deri në varrim. Përballë këtij kujdesi Muhaxhirët thanë:

Ne braktisëm shtëpinë dhe vendlindjen, sakrifikuar jetën dhe pasurinë për të mbrojtur besimin.

Por kujdesi i Profetit ﷺ për këtë shërbëtor është më i madh se kujdesi ndaj nesh.” Kurse Ensarët thanë:

Edhe ne sakrifikuar jetën dhe pasurinë tonë në rrugën e Allahut, por kujdesi i Profetit ﷺ ishte më i

madh për këtë shërbëtor. Për këtë arsye zbriti ajeti kuranor: **“Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij.”** (Huxhurat, 13)

Ky ajet, nuk zbriti për një njeri të pasuri dhe me pozitë, por për një skllav i cili në dukje ishte i tillë, por në të vërtetë ishte një mbret.

Çfarë kërkoi ai si shpërblim? Ai kërkoi të ishte me Profetin ﷺ. Përse e kërkoi këtë gjë? Që të ishte së bashku me Profetin ﷺ në sexhde.



TË KUJDESIMI SI PËR VETEN

Pyetje: *Këshilla juaj që t'i japim punëtorit ushqimin që hamë vetë, a mund të shërbejë edhe si kriter për të përcaktuar pagën?*

Osman Nuri Topbash: Kjo porosi profetike mund të aplikohet edhe në ditë tona. Në Epokën e Lumturisë skllëvërit janë shpërblyer më shumë se sa u takonte realisht. Një kusht i tillë ishte vendosur me qëllim që të krijohej mundësia për t'i liruar. Për rrjedhojë, ishte bërë më e lehtë ta liroje skllavin se sa ta mbaje. Madje, për të zhdukur dallimin, ishin bërë edhe martesat me njerëz të lirë. Si rezultat i këtyre normave, shumë skllëvër jomuslimanë kanë pranuar Islamin.

“Allahu e ndihmon këtë ummet për shkak të lutjes, namazeve dhe singeritetit të të pafuqishmëve”.

(Nesai, Xhihad, 43)

Në luftën e Bedrit, vëllai i sahabiut të famshëm Mus'ab ibn Umejrit, u kap rob. Si gjithë robërit e tjerë, edhe ai i takoi një shtëpie, por të varfër. Për të shpëtuar nga robëria, ai duhej t'u mësonte fëmijëve shkrim dhe lexim. Megjithatë shumë të varfër, familja ia jepnin ushqimin robit që u mësonte fëmijët, kurse për vete hanin hurma. Vetë Ebu Azizi

thoshte: Më vinte turp kur vetë hanin hurma kurse mua më sillnin ushqimet më të mira që kishin.

Nga turpi u thashë: Mos e bëni këtë. Edhe unë ha hurma si ju, ushqimet jepjani fëmijëve tuaj. Mirëpo, ata thanë: Në asnjë mënyrë! Kështu na ka urdhëruar Profeti ﷺ.

Pyetje: *A mund të vijë shoqëria Islame në një gjendje ku dallimi në të ardhura të jetë jash-tëzakonisht i madh?*

Osman Nuri Topbash: Kur në një shoqëri he-ndeku midis të pasurit dhe të varfrit është shumë i madh, në atë shoqëri nuk mund të bëhet më fjalë për siguri dhe qetësi. Gjendja e një shoqërie ku të pasurit janë koprracë dhe koprracët janë të pasur, është e mjerueshme.

Prandaj është e domosdoshme që muslimanët e pasur të pajisen me moralin Islam të ndihmës, solidaritetit dhe vëllazërisë. Por edhe muslimanët e varfër duhet të tregojnë durim, vetëmjaftueshmëri dhe të përpiqen të fitojnë në rrugë legjitime. Ata nuk duhet të lakmojnë pasurinë e tjetrit dhe të ushqejnë urrejtje për të pasurit. Vetëm në këtë mënyrë, në një shoqëri vendin e zënkave e zë dashuria dhe vëllazëria.



TË PUNOSH SI MYSLIMAN NË NJË SISTEM KAPITALIST

Pyetje: *Pyetja e fundit për të bërë një vlerësim të përgjithshëm. A është e mundur të punosh si musliman në një sistem kapitalist? Nëse po, ku duhet të bëjmë kujdes?*

Osman Nuri Topbash: Jetesa në sistemin kapitalist megjithëse e vështirë, është e mundur. Jeta ekonomike dhe tregtare në periudhën e injorancës nuk ishte më e mirë se kjo e sotmja. Kamata, interesi, padrejtësia, mashtrimi kishin arritur nivele të frikshme. Në këto kushte e ushtroi aktivitetin e tij tregtar edhe Profeti ﷺ. Në këto kushte mbolli edhe farën e jetës ekonomike të bazuar mbi themelet e së drejtës Islame.

Në shoqërinë e Epokës së Lumturisë nuk ekzistonte kamata dhe interesi që shkaktojnë inflacion, duke e bërë të pasurin më të pasuri dhe të varfrin më të varfër.

Besimtarët, gjatë gjithë historisë e kanë vazhduar sistemin e vet brenda një sistemi të huaj. Sepse muslimani e ruan besimin dhe identitetin e tij në



çfarëdo shoqërie qoftë. Ai është si një gur i çmuar që nuk e humbet vlerën edhe kur bie në baltë. Besimtari pra është një person me personalitet të lartë dhe karakter të fortë. Ai e ruan freskinë e besimit të vet në çfarëdo gjendje.

Muslimani e rregullon jetë e tij sipas parimeve dhe mësimave Islame dhe jo sipas tekave të kapitalizmit. Besimtari tregohet i kujdesshëm ndaj normave islame, respekton në maksimum kufijtë hallall-haram.

Në fakt, besimtarët që kanë mundur të respektojnë urdhëresat hyjnore në një sistem të tillë janë bërë një shembull i shkëlqyer për njerëzit përreth. Madje janë bërë shkak edhe për udhëzimin e njerëzve.

Rëndësinë dhe begatinë e mos përzierjes së haramit në fitim duke i kushtuar vëmendje fitimit hallall në tregti, i ndjeri im atë, Musa Efendi e tregonte me këtë ngjarje:

“Kishim një komshi jomusliman. Ai u bë musliman më vonë. Një ditë, kur e pyeta shkakun pse ishte bërë musliman, më tha:

“U bëra musliman me pretekstin e moralit të bukur në tregti të Rebi Mollait që e kisha komshi toke bujqësore në Axhibadem. Molla Rebiu ishte një person që e siguronte jetesën duke shitur qumësht. Një mbrëmje erdhi tek ne dhe na tha:

“Tregtari i guximshëm që nxjerr mallin në shitje, i shtohet, ndërsa tregtari që fsheh mallin e tij për ta shitur me çmim më të lartë, është i mallkuar.”

(Ibn Maxhe, Tixharet, 6.)

“Urdhëroni, ky qumështi është juaji!”

Unë u habita:

“Si ka mundësi? Unë nuk kam kërkuar qumësht nga ju!”

Ai njeri i ndjeshëm dhe delikat më tha:

“Pa e vënë re unë, njëra nga bagëtitë kishte hyrë në kopshtin tuaj dhe po kulloste. Prandaj ky qumësht është juaji! Por jo vetëm kaq. Unë do të vazhdoj t’jua sjell qumështin e bagëtisë gjersa bari që ka ngrënë te ju t’i dalë plotësisht jashtë trupit!”

Unë ia pritja:

Fjalë për t’u thënë janë këto, komshi? E çfarë hëngri? Bar! I qoftë hallall!”

Por Molla Rebiu s’u bind! Ai nguli këmbë në të vetën:

“Jo, jo, s’është punë që bëhet! Qumështi i saj është haku juaj!”

Dhe vazhdoi të na sjellë qumësht gjersa u bind se e kishte larë detyrimin”!

Ja pra, kjo sjellje e atij njeriu të bekuar më preku tepër. Si rezultat, m’i ngriti perdet e padijes dhe indiferentizmit mbi sy dhe në shpirt më lindi dielli i rrugës së drejtë!

Thashë me vete:

“Feja e një njeriu me një moral të tillë të lartë, pa dyshim që është një fe e lartë! Nuk mund të kihet dyshim mbi drejtësinë e fesë që përgatit njerëz të tillë delikatë, të drejtë, të përkryer e të pastër!”



Pastaj shqiptova Fjalën e Dëshmisë dhe u bëra musliman!”

Njerëzit mahniten mbas njerëzve me karakter dhe personalitet të përsosur. Sepse sjellja më e vogël e një personaliteti shembullor, në shumë raste ndikon më shumë se sa fjala. Shembull tipik i kësaj është kjo ndodhi historike:

Një tregtar trikotazhi, i cili e kishte mbrujtur zemrën me bukuritë e Islamit, një ditë niset për tregti në Indonezi. Pasi vendoset në Indonezi, fillon të shesë mallin në pazar.

Malli që kishte sjellë ishte shumë cilësor, por ngaqë nuk ishte lakmitar për të fituar shumë, mendoi se ishte më mirë të fitonte pak, por në mënyrë hallall. Prandaj, kërkesën e lartë për mallrat e

*Kur një person i lëndoi dikënd në prani të
Omerit ﷺ, ai i tha:*

*A e ke fqinjë, a ke bërë udhëtim me të, a ke bërë
tregti bashkë me të?*

*Kur personi tha nuk kam bërë asnjërën,
Omeri ﷺ i tha:*

*Ti e ke parë atë në xhami duke lexuar Kuran
prandaj e lëndon. Po tha personi.*

*Atëherë mos e lëndo shumë sepse sinqeriteti
i njeriut nuk është në tundjen e kokës gjatë
leximit të Kuranit.*



tij nuk e kishte shfrytëzuar asnjëherë për të ngritur çmimin.

Një ditë, kur erdhi vonë në punë, vuri re se shërbëtori kishte fituar shumë para nga mallrat e shitur. Dhe midis tyre u zhvillua ky dialog:

- Prej cilit stof ke shitur?

- Nga ky këtu zotëri.

- Sa e shite?

- Dhjetë dinarë.

- Si e shite dhjetë dinarë një pëlhurë që kush-ton pesë dinarë? I kemi hyrë në hak njeriut të shkretë. Nëse e shikon, a e njeh?

- Po zotëri, e njoh!

- Atëherë, shko menjëherë, gjeje dhe sille këtu.

Shërbëtori iku menjëherë, e gjeti klientin dhe e solli tek tregtari.

Tregtari, sapo e pa klientin i kërkoi falje atij dhe iu lut që t'ia bënte hallall dhe tha: "Na falni, punëtori gabimisht stofin që kushtonte 5 dinarë e ka shitur 10 dinarë." Dhe i zgjati klientit 5 dinarët e tepërt, duke i thënë se kjo ishte pjesa e tepërt që i perkiste atij.

Klienti u mahnit nga kjo sjellje sublime. Ishte hera e parë që përballej me një sjellje të tillë. Kur-rë më parë nuk kishte dëgjuar për një rast si ky. Blerësi po mendonte mbi fjalët "ma bëj hallall". Si ka mundësi një gjë e tillë? Copën e stofit e kishte marrë me pëlqimin e vet. Megjithatë, falënderoi tregtarin dhe doli nga dyqani.



Ngjarja filloi të përcillej gojë më gojë dhe brenda një kohe të shkurtër u dëgjua në të gjithë qytetin. Të gjithë i tregonin njëri-tjetrit për këtë ngjarje. Pa kaluar shumë, çështja i ra në vesh mbretit, i cili vendosi ta thërriste shitësin e stofit në sarajet e tij. Ai dëshironte të mësonte si qëndronte puna. Një gjë e tillë ndodhte për herë të parë në mbretërinë e tij. Në popullin e tij ishte e pamundur të ndodhte një gjë e tillë, sepse gjithkush e shiste mallin e vet sipas dëshirës. Cili ishte shkaku që e shtynte tregtarin të bënte një veprim të tillë?

Mbreti e pyeti:

- Këtë veprim që ju keni bërë, ne as e kemi parë as e kemi dëgjuar më parë. Si është e vërteta e kësaj sjelljeje? Cili është shkaku që ju shtyn të bëni një veprim të tillë?

- Unë-, tha tregtari-, jam mysliman, jam besimtar. Feja islame kështu urdhëron. Atë stof e kisha blerë 4 dinarë dhe e shisja 5, por shërbëtori e kishte shitur 10 dinarë. Kështu që unë i kisha hyrë në hak klientit dhe për këtë shkak në mallin tim ishte përzier edhe fitimi haram. Unë vetëm rregullova një gabim të bërë.

Mbreti bëri disa pyetje të njëpasnjëshme:

Ç 'është Islami? Ç 'është morali islam? Tregtari iu përgjigj një e nga një pyetjeje të mbretit. Pa kaluar

"Allahu e trajtoi me mëshirë dikë që pati jetuar para jush, sepse ai tregonte lehtësi kur shiste, kur blinte dhe kur kërkonte borxhin!"

(Tirmidhi, Buju, 75/1320)

shumë kohë, mbreti pranoi Islamin dhe mbas tij i gjithë populli.

Ndoshta shkaku i pranimi të Islamit nga një vend me popullsi 250 milion banorë është pikërisht ky moral i bukur Islam, i shfaqur nga ai tregtar.

Prandaj, duhet që vazhdimisht, në çdo situatë dhe vend të ekspozojmë moralin e bukur të Islamit.



ETIKA E TREGTISË

Si përfundim duhet të gjithë të fillojmë një fuqatë për ringjalljen e moralit në biznes dhe tregti në shoqërinë tonë ku ka një dobësim të ndjenjave vëllazërore dhe humbje të qetësisë sociale, ku vendin e ndjenjave pozitive e kanë zënë urrejtja, smira dhe armiqësia.

Besimtari më shumë se kurrë ka nevojë për një pjekuri morale. Për më tepër, në këtë kohë kur njerëzit i janë nënshtruar materiale duke harruar botën tjetër. Është e domosdoshme të respektojmë të drejtën e tjetrit duke u nisur nga frika ndaj Allahut.

Redaksia: *Shumë faleminderit i nderuar. Ishte një bashkëbisedim shumë i këndshëm dhe i frytshëm.*

Osman Nuri Topbash: Falëminderit juve dhe Allahu jua shpërbleftë.

Dua të theksoj që revista Etika është një shkollë në vete me 2500 nxënës. Me këtë sy duhet ta shohim. Një person që hap një shkollë me 100 veta shprehet me gëzim se ka udhëzuar 100 vetë. Nëse



një person lexon vetëm një faqe të kësaj reviste përsëri është përfitim dhe shpërblim i madh. Sot çdo numër i revistës Etika është një mesazh që i shkon të panjohurit. Nuk dihet se në dorë të kujt do të bjerë. Ndoshta bëhet rrugëzgjdhje për një që ka probleme.

Ky mesazh, kjo letër shkon tek të gjithë. Kjo shkon tek burri, gruaja, fëmija, i riu, i moshuari, akademiku, pra tek të gjitha nivelet sociale. Ky është një shërbim shumë i madh. Allahu ka bërë të mundur që ky shërbim të vazhdojë për shumë vite. Me shpresën që të shërbejë si shpërblim i vazhdueshëm...



PËRMBAJTJA

Parathënia.....	5
Mentaliteti “Kështu funksionon sot”	15
Mrënoja njerëzore.....	18
Tre parimet e Islamit.....	20
Krahasimi i islamit me kapitalizmin.....	23
Epoka e tulipanëve.....	25
A është dobësia justifikim?.....	30
Mburoja e devotshmërisë përballë sistemit ekzistues.....	33
A e dëmton pasuria myslimanin?.....	35
Qëndrimi islam përballë kapitalizmit.....	40
Për të parandaluar erozionin shpirtëror... ..	44
Në islam nuk ekziston mentaliteti: fito si të fitosh.....	50
Një kujtim nga Garaudy.....	53
Shembuj nga Imam Ebu Hanife.....	56
Nëse mblidhen 100 të njerëz të pasur.....	61
Sa pjesë e pasurisë shkon për bamirësi	64



Islami është si një farmaci	67
Si ndikon disiplina mistike në sprovën e parasë?	69
Nëse Islami jetohet në shoqëri	74
Sprova e pasurisë dhe varfërisë	75
“Dynjaja është indiferencë ndaj Zotit”	78
Pak shpenzim, shumë bamirësi	82
Kriteri i shpërdorimit dhe luksit	84
Shikoni jetën e sahabëve	90
Peshore argjendari dhe peshore druvari	93
Mashtrimi përmes reklamave	95
Këto kritere janë vetëm për të devotshmit?	98
Problemi kryesor është edukimi shpirtëror	103
Marrëdhënia punëtor-punëdhënës	106
Të kujdesimi si për veten	110
Të punosh si musliman në një sistem kapitalist	112
Etika e tregtisë	119

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Topbas, Osman Nûri
Sprova e Pasurisë / Osman Nuri Topbash;
përkth. Albert Halili; red. Ilir Hoxha;

Shkodër : Progresi, 2020
124 f.; 11 x 18 cm.

Tit. origj.: Müslümanın para ile imtihanı
ISBN 978-9928-207-38-8

1.Feja islame 2.Besimi 3.Doktina fetare
28 -12